



**Udhërrëfytyesi Strategjik i BQK-së për Menaxhimin dhe
Mbikëqyrjen e Rreziqeve të lidhura me Klimën dhe Mjedisin
në sektorin financiar për vitet 2025-2027**

Dhjetor
2024

Përmbajtja

Shkurtesat	4
Fjalorthi	6
Hyrje	10
Përmbledhje ekzekutive	11
1. Rëndësia në kontekstin e Republikës së Kosovës	16
2. Rreziqet financiare të lidhura me klimën në arenën ndërkombëtare	18
2.1. Iniciativat rregullatore për rreziqet financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar	18
2.2. Taksonomitë dhe iniciativat e tjera rregullatore	25
2.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar	27
3. Ekspozimi dhe menaxhimi i rreziqeve klimatike në sektorin bankar në Republikën e Kosovës	27
3.1. Pasqyrë e sektorit financiar	27
3.2. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën (FinSAC)	29
3.2.1. Identifikimi i rreziqeve kryesore të lidhura me klimën	29
3.2.2. Kanalet e transmetimit	31
3.2.3. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tranzicionit	32
3.2.4. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve fizike	36
4. Udhërrëfytye strategjike lidhur me rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin në sektorin financiar .	36
4.1. Parimet	36
4.2. Aktivitetet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	37

Kutitë

Kutia 1: Parimet e BCBS për menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive të rreziqeve financiare të lidhura me klimën	21
Kutia 2: Skenarët e Rrjetit për Gjelbërimin e Sistemeve Financiare (NGFS)	24
Kutia 3: Gjashtë objektivat mjedisore të BE-së dhe katër parimet për aktivitetet të qëndrueshëm ekonomik	26

Figurat

Figura 1: Lista e parimeve mbi të cilat bazohet Strategjia	13
Figura 2: Udhërrëfytye 2025-2027	15
Figura 3: Pritshmëritë e BQE-së për bankat	20
Figura 4: Standardi për stres-testet lidhur me klimën	23
Figura 5: Bilanci i gjendjes së sektorit bankar - asetet	28
Figura 6: Stoku i totalit të depozitave	29
Figura 7: Kanalet kryesore të transmetimit të ndryshimeve klimatike	32
Figura 8: Pjesa e CPRS-së dhe e sektorëve të tjerë në ekspozimin e bankave të Republikës së Kosovës 2018-2022	34
Figura 9: Zbërthimi i ekspozimit të bankave ndaj sektorëve të lidhur me politikën klimatike për periudhën 2018-2022	35
Figura 10: Kategoritë e aktiviteteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	38

Tabelat

Tabela 1: Numri i institucioneve financiare dhe pjesa në Kosovë	28
Tabela 2: Klasifikimi i sektorëve sipas NACE-së	33

Shkurtesat

ACPR: Autorité de Contrôle Prudentiel et de Resolution
AWC: Këshilli Arab për Ujëra
BCBS: Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare
BCP-të: Parimet Themelore për Mbikëqyrje Efektive të Bankave
BoE: Banka e Anglisë
BPF: Faktorët penalizues “të kaftë” [të karburanteve fosile]
BQK: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CDS: Këmbimi i mospagesave/mospërmbushjeve [default] kreditore
CEDARE: Qendra për Mjedis dhe Zhvillim për Rajonin Arab dhe Evropën
CEO: Kryeshefi Ekzekutiv
CH4: Metani
CO2: Dioksid karboni
CPRS: Sektorët relevantë të politikës klimatike
CRD: Direktiva për Kërkesat e Kapitalit
CRR: Rregullorja e Kërkesave të Kapitalit
DNB: De Nederlandsche Bank
ABE: Autoriteti Bankar Evropian
BERZH: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BQE: Banka Qendrore Evropiane
EGD: Marrëveshja e Gjellbër Evropiane
ESG: Faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes
BE: Bashkimi Evropian
EUR: Euro
BSF: Bordi i Stabilitetit Financiar
GAWB: Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor
BPV: Bruto Produkti Vendor
GS: Gazrat Serrë
GSF: Faktori Mbështetës i Gjellbër
H₂O: Avujt e ujit
ICAAP: Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit
ILAAP: Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit
IFD: Direktiva për Shoqëritë Investuese
FMN: Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPCC: Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
IPSF: Platforma Ndërkombëtare për Financat e Qëndrueshme
ASK: Agjencia e Statistikave të Kosovës
FKGK: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
M3: Metër kub
MMPH: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Mt: Tonë metrikë
N₂O: Oksidi i azotit
NACE: Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NDC: Kontributet e Përcaktuara Kombëtare
NGFS: Rrjeti për Gjellbërimin e Sistemit Financiar
O₃: Ozoni
OeNB: Oesterreichische Nationalbank
OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
NVM-të: Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SREP: Procesi i rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës
TCFD: Task Forca për Shpalesjet e Financave të Lidhura me Klimën

TEG: Grupi i Ekspertëve Teknikë për financat e qëndrueshme

OKB: Kombet e Bashkuara

UNDP: Programi për Zhvillim i OKB-së

UNFCCC: Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

USAID: Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

WMO: Organizata Botërore Meteorologjike

Fjalorthi

Kjo Strategji për Rreziqet e lidhura me Klimën dhe Mjedisin në sektorin financiar për vitet 2025-2027 (në tekstin e mëtejme "Strategjia") përfshinë një sërë termash që lidhen me rreziqet nga ndryshimet klimatike dhe ato mjedisore, si dhe financat e qëndrueshme. Kuptimi i tyre është si në vijim¹:

- 1) **Intensiteti i karbonit²/Intensiteti i emetimeve** është sasia e emetimeve të dioksidit të karbonit (CO₂) të çliruar për njësi të një variabli tjetër si p.sh. Bruto Produkti Vendor (BPV), përdorimi i energjisë së prodhimit ose transporti. Një aktivitet ose proces është me intensitet karboni nëse ka intensitet të lartë karboni në krahasim me një standard të caktuar.
- 2) **Taksimi i karbonit (taksa e karbonit)** përgjithësisht i referohet një takse të vendosur mbi përmbajtjen e karbonit të disa mallrave dhe shërbimeve, zakonisht në sektorët e transportit dhe/ose të energjisë. Qëllimi është reduktimi i emetimeve të CO₂ duke rritur çmimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve. Është një nga llojet kryesore të instrumenteve të përdorura në politikat e ndryshimeve klimatike në mbarë botën.
- 3) **Klima** në kuptim të ngushtë zakonisht përkufizohet si 'moti mesatar', apo edhe më saktë si përshkrim statistikor i mesatares dhe variabilitetit të sasive relevante brenda një periudhe kohore, me shtrirje nga disa muaj e deri tek mijëra e miliona vjet. Periudha kohore e përdorur më së shpeshti nga Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM) për mesataren e këtyre variablave është 30 vite. Sasitë relevante janë më së shpeshti variabla sipërfaqësore si temperatura, reshjet dhe era. Klima në kuptim më të gjerë nënkupton gjendjen, përfshirë përshkrimin statistikor, të sistemit klimatik.
- 4) **Projeksioni klimatik** është reagimi i simuluar i sistemit klimatik ndaj një skenari të emetimit ose përqendrimit të ardhshëm të gazrave serrë dhe aerosoleve, të përfuturara përgjithësisht duke përdorur modele klimatike. Projektionet klimatike dallohen nga parashikimet klimatike nga varësia e tyre në skenarin e përdorur shtytës/nxitës të emetimit/përqendrimit/rrezatimit, i cili nga ana e tij bazohet në supozime, për shembull, në lidhje me zhvillimet e ardhshme socio-ekonomike dhe teknologjike që mund ose mund të mos realizohen.
- 5) **Rreziqet financiare të lidhura me klimën** janë rreziqe potenciale që mund të lindin nga ndryshimet klimatike ose nga përpjekjet për të zbutur ndryshimet klimatike, ndikimet e tyre dhe pasojat e tyre ekonomike dhe financiare.
- 6) **Ndjeshmëria klimatike** është ndryshimi në temperaturën mesatare vjetore globale të sipërfaqes në përgjigje të një ndryshimi në përqendrimin e CO₂ në atmosferë ose një shtytësi tjetër rrezatues.
- 7) **Cenueshmëria klimatike** është prirja ose predispozita për t'u ndikuar negativisht. Ajo përfshinë një sërë konceptesh dhe elementesh duke përfshirë ndjeshmërinë ose ekspozimin ndaj dëmtimit dhe mungesën e kapacitetit për t'u përballur dhe për t'u përshtatur. Në kontekstin e nxitësve/shtytësve të rrezikut klimatik, cenueshmëria i referohet nivelit të dëmtimit që mund të pritët në nivele të ndryshme të intensitetit të një rreziku. Për shembull, kur një valë stuhie godet një zonë me rregullativë të dobët ndërtimi dhe me masa të pamjaftueshme zbutëse ndaj përmytjeve, ajo është më e cenueshme ndaj humbjeve në krahasim me një zonë që ka infrastrukturë të fortë të kontrollit ndaj përmytjeve dhe rregullativë të fortë ndërtimi. Vlerësimet e cenueshmërisë mund të përfshijnë ndikime dytësore si ndërprerja e punës/aktivitetit.
- 8) **Ekonomia me qark të mbyllur, ose ekonomia qarkore**, nënkupton një model zhvillimi ekonomik të bazuar në riciklimin dhe konsumin racional të burimeve. Kësisoj, një ekonomi me qark të mbyllur është një alternativë ndaj ekonomisë tradicionale lineare.

¹ Përkufizimet e termave të përdorur janë marrë nga "nxitësit e rrezikut të lidhur me klimën BCBS dhe kanalet e tyre të transmetimit"

² Gjithashtu shihet si "karbon-intensiv"

- Një ekonomi me qark të mbyllur karakterizohet nga krijimi i qasjeve të reja ekonomike alternative që synojnë të minimizojnë ndikimin negativ të njeriut në mjedis.
- 9) **ESG** (faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes) i referohet një sërë kriteresh që luajnë një rol në procesin e vendimmarrjes për investime ose në operacionet e një kompanie. Faktorët mjedisorë marrin parasysh se si një investim ose një kompani ndikon në çështjet mjedisore si ndryshimi klimatik dhe qëndrueshmëria. Faktorët socialë shqyrtojnë ndikimet sociale të një investimi ose një kompanie në komunitet. Qeverisja lidhet me transparencën dhe pajtueshmërinë ligjore të një investimi ose të operacioneve të një kompanie, për shembull për sa i përket kontabilitetit dhe të drejtave të aksionarëve.
 - 10) **Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG)** nënkupton probabilitetin e humbjeve ose shpenzimeve shtesë, ose humbjen e të ardhurave të planifikuara, ose humbjen e reputacionit të një institucioni financiar për shkak të ndikimit negativ financiar të faktorëve aktualë ose të ardhshëm ESG mbi palët tjera dhe asetet e tyre.
 - 11) **Temperatura mesatare globale e sipërfaqes** është mesatarja globale e vlerësuar e temperaturave të ajrit afër sipërfaqes mbi tokë dhe akullit të detit, dhe temperaturave të sipërfaqes së detit mbi rajonet e oqeanit pa akull, me ndryshime normalisht të shprehura si shmangie nga një vlerë gjatë një periudhe të caktuar referuese. Kur vlerësohen ndryshimet në temperaturën mesatare globale të sipërfaqes, përdoren gjithashtu temperaturat e ajrit pranë sipërfaqes si mbi tokë ashtu edhe mbi oqeanet.
 - 12) **Ngrohja globale** është rritja e vlerësuar e temperaturës mesatare globale të sipërfaqes si mesatare gjatë një periudhe 30-vjeçare, ose periudha 30-vjeçare e përqendruar në një vit ose dekadë të caktuar, e shprehur në raport me nivelet paraindustriale, përveç nëse specifikohet ndryshe. Për periudha 30-vjeçare që përfshijnë vitet e kaluara dhe të ardhshme, supozohet të vazhdojë trendi aktual i ngrohjes shumë-dekadëshe.
 - 13) **Gazrat serrë (GS)** janë ata përbërës të gaztë të atmosferës, si natyrorë ashtu edhe antropogjenë (të lidhur me njeriun), që thithin dhe emetojnë rrezatim në gjatësi vale specifike brenda spektrit të rrezatimit termik infra të kuq të emetuar nga sipërfaqja e Tokës, nga vetë atmosfera dhe nga retë. Kjo veti shkakton efektin serrë. Avulli i ujit (H₂O), dioksidi i karbonit (CO₂), oksidi i azotit (N₂O), metani (CH₄) dhe ozoni (O₃) janë gazrat primare serrë në atmosferën e Tokës.
 - 14) **Ekonomia e gjelbër** (ekonomi me karbon të ulët) nënkupton një ekonomi me emetim të ulët të karbonit që përdor burimet në mënyrë efikase dhe është në interes të publikut.
 - 15) **“Greenwashing” [Shpëlarja e gjelbër]** nënkupton çorientimin e kreditorëve, investitorëve dhe agjentëve të tjerë ekonomikë në lidhje me përdorimin e fondeve të huazuara ose të investuara në lidhje me synimet e institucionit financiar për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm duke marrë parasysh faktorët ESG në mënyrë që të kërkohet trajtim ose kushte financiare më të preferuara nga investitori, huamarrësi ose konsumatori.
 - 16) **Kanalet makro (ose makroekonomike) të transmetimit** janë mekanizmat me të cilët nxitësit e rrezikut klimatikë ndikojnë në faktorët makroekonomikë, si produktiviteti i punës dhe rritja ekonomike, dhe se si këto, nga ana tjetër, mund të kenë ndikim tek bankat nëpërmjet një efekti në ekonominë në të cilën bankat operojnë. Kanalet makroekonomike të transmetimit regjistrojnë gjithashtu efektet në variablat makroekonomikë të tregut si normat e interesit pa rrezik, inflacioni, mallrat dhe normat e këmbimit valutor.
 - 17) **Kanali mikro (ose mikroekonomik) i transmetimit** është një mekanizëm përmes të cilit nxitësit e rrezikut klimatikë prekin kundërpalët individuale të bankave, duke rezultuar potencialisht në rrezik financiar të lidhur me klimën për bankat dhe sistemin financiar. Kjo përfshinë efektet e drejtpërdrejta në vetë bankat, që paraqiten nga ndikimet në operacionet e tyre dhe aftësinë e tyre për tu vetëfinancuar. Kanalet mikroekonomikë të transmetimit regjistrojnë gjithashtu efektet indirekte mbi asetet financiare me emër

- specifik të mbajtura nga bankat (p.sh. obligacionet, kontratë kreditore kundërkëmbimi e dështuar/pashlyer me emër të vetëm - single name CDS dhe aksionet).
- 18) **Rrezik/Hazard fizik (ose hazard)** është shfaqja e mundshme e një ngjarjeje fizike natyrore ose të shkaktuar nga njeriu ose trend ose ndikim fizik që mund të shkaktojë humbje jete, lëndime ose ndikime të tjera shëndetësore, si dhe dëmtime dhe humbje të pronës, infrastrukturës, mjeteve të jetesës, ofrimit të shërbimeve, ekosistemeve, dhe burimeve mjedisore. Në këtë raport, termi rrezik [hazard] i referohet ngjarjeve ose trendeve fizike të lidhura me klimën ose ndikimeve të tyre fizike.
- 19) **Rreziqet fizike** janë kostot ekonomike dhe humbjet financiare që rezultojnë nga ashpërsia dhe shpeshtësia në rritje e:
- i. Ngjarjeve ekstreme të motit të lidhura me ndryshimet klimatike (ose ngjarjeve ekstreme të motit) si valët e të nxehtit, rrëshqitjet e dheut, përmbytjet, zjarret dhe stuhitë (d.m.th., rreziqe akute fizike).
 - ii. Ndryshimet graduale afatgjata të klimës si ndryshimet në reshje, ndryshueshmëria ekstreme e motit, acidifikimi i oqeanit dhe rritja e nivelit të detit dhe temperaturave mesatare (d.m.th. rreziqet fizike kronike ose rreziqet kronike).
 - iii. Efektet indirekte të ndryshimeve klimatike si humbja e shërbimeve të ekosistemit (p.sh., shkretëtirëzimi, mungesa e ujit, degradimi i cilësisë së tokës ose ekologjisë detare).
- 20) **Nxitësit e rrezikut fizik** janë ndryshimet e motit dhe të klimës të përmendura më sipër që çojnë në rritje të rreziqeve fizike dhe ndikimeve në ekonomi dhe banka (p.sh. një përmbytje).
- 21) **Aset i bllokuar** është një aset që në një moment kohe para përfundimit të jetës së tij ekonomike nuk është më në gjendje të fitojë kthim ekonomik si rezultat i ndryshimeve që lidhen me kalimin në një ekonomi me karbon të ulët.
- 22) **Zhvillim i qëndrueshëm** nënkupton një prosperitet ekonomik afatgjatë që është më pak i varur nga përdorimi i burimeve të kufizuara dhe shfrytëzimi i mjedisit, është më gjithëpërfshirës në aspektin social dhe përfshinë aspekte të ndërlidhura ngushtë të ESG-së.
- 23) **Pika e kthesës** është një nivel ndryshimi në vetitë e sistemit përtej të cilës një sistem riorganizohet, shpesh papritur, dhe nuk kthehet në gjendjen fillestare edhe nëse nxitësit e ndryshimit janë pakësuar. Për sistemin klimatik, ajo i referohet një pragu kritik kur klima globale ose rajonale ndryshon nga një gjendje e qëndrueshme në një gjendje tjetër të qëndrueshme.
- 24) **Rreziku i tranzicionit** (rreziqet e kalimit në modelin e ekonomisë me karbon të ulët) i referohet humbjes financiare të një institucioni që mund të rezultojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga procesi i përshtatjes drejt një ekonomie me karbon më të ulët dhe më të qëndrueshme për mjedisin.
- 25) **Nxitësit e rrezikut të tranzicionit** përfaqësojnë ndryshime të lidhura me klimën që mund të gjenerojnë, të rrisin ose të zvogëlojnë rreziqet e tranzicionit. Ato përfshijnë ndryshime në politikat e sektorit publik (në përgjithësi të qeverisë), legjislacionin dhe rregullativën, ndryshimet në teknologji dhe ndryshimet në sentimentin e tregut dhe të konsumatorit, secila prej të cilave ka potencialin të gjenerojë, të përshpejtojë, të ngadalësojë ose të pengojë tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët.
- 26) **Kanalet e transmetimit** janë zinxhirë shkakësorë që shpjegojnë se si nxitësit e rrezikut të klimës shkaktojnë rreziqe financiare që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi tek bankat nëpërmjet kundërpalëve të tyre, aseteve, aseteve jashtëbilancore që ata mbajnë, burimeve të tyre të financimit dhe ekonomisë në të cilën ato operojnë.
- 27) **Taksonomia** e aktiviteteve ekonomike nënkupton një sistem klasifikimi që përcakton një listë të aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme për nga aspekti mjedisor dhe pragjeve (kriteret e shqyrtimit teknik) që mund të përcaktojnë qartë se cili aktivitet

ekonomik është në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm, qëllimet mjedisore dhe parimet e aktivitetit të qëndrueshëm ekonomik. Një taksonomi e tillë ndihmon investitorët, emetuesit, dhe promovuesit e projekteve të fokusohen në kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët, rezistente ndaj rrezikut, dhe efikase ndaj burimeve, dhe lehtëson një sistem të shpalosjes të klimës.

Hyrje

Ndryshimet klimatike dhe tranzicioni drejt një ekonomie më të gjelbër dhe më pak intensive me karbon është një proces që tashmë është duke u zhvilluar në nivel global dhe do të ndikojë jo vetëm planetin dhe ekonominë, por edhe sistemet financiare. Në këtë zhvillim, rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sistemit financiar po marrin një rol të ri. Ata po marrin një rol proaktiv në ndërtimin e qëndrueshmërisë së bankave ndaj rreziqeve financiare në zhvillim që paraqiten nga ndryshimet klimatike dhe aftësisë së bankave për të mbështetur tranzicionin në mbarë ekonominë drejt emetimeve neto zero. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: BQK) nuk do të veprojë ndryshe në këtë aspekt nga roli i BQK-së i përcaktuar me Ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare apo ligji që e pason dhe Ligjin për BQK-në, ku do të angazhohet në mënyrë aktive në drejtimin e bankave në lidhje me rreziqet e lidhura me klimën dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së tyre me rregulloret përkatëse. Korniza strategjike e përfshirë në këtë dokument pasqyron përpjekjet për të iniciuar aktivitetet e nevojshme për përcaktimin e pritshmërive rregullatore dhe mbikëqyrëse për identifikimin, vlerësimin, qeverisjen, menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve të lidhura me klimën ndaj të cilave ato janë të ekspozuara.

Komuniteti ndërkombëtar ka ndërmarrë hapa të paprecedentë në hartimin dhe zbatimin e strategjive, veprimeve dhe udhërrëfytyesve që pritet të shpijnë në objektivat e Marrëveshjes së Parisit. Edhe pse Republika e Kosovës nuk është palë e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Marrëveshjes së Parisit, Republika e Kosovës në vitin 2021 filloi një diskutim me palët ndërkombëtare të interesit për të përgatitur kontributet e përcaktuara kombëtare vullnetare (të detyrueshme vetëm për ata që janë pjesë e Marrëveshjes së Parisit), duke dëshmuar përkushtimin e saj ndaj objektivave. Zbatimi i zotimeve të vendit nga Deklarata e Sofjes dhe nisma të tjera ndërkombëtare që Republika e Kosovës mund të nënshkruajë ose mund të jetë pjesë e tyre, nuk janë nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të BQK-së. Prandaj, kjo Strategji reflekton se roli i BQK-së nuk duhet të jetë në inkurajimin e rrjedhave financiare drejt investimeve më të gjelbra, por të sigurojë që bankat të identifikojnë, të menaxhojnë, të qeverisin, të kontrollojnë dhe të raportojnë siç duhet rreziqet që lidhen me klimën ndaj të cilave ato janë të ekspozuara. Megjithatë, kjo nuk bie ndesh me faktin se investimet më të gjelbra mund të ulin ekspozimin e sektorit financiar ndaj rreziqeve të tranzicionit.

Qëllimi i Strategjisë është i pesëfishtë. Së pari ajo ofron një pasqyrë të zotimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe punën drejt një ekonomie më të qëndrueshme për të përshkruar mjedisin e përgjithshëm në vend lidhur me ndryshimet klimatike. Së dyti, dokumenti shqyrton shkurtimisht zhvillimet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe evropiane në kornizën rregullatore dhe mbikëqyrëse të rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, duke përfshirë nga institucionet evropiane (EBA, ECB, etj.) dhe ato ndërkombëtare (p.sh. BCBS), për të ofruar një standard për fushën e punës së kryer nga mbikëqyrësit e tjerë. Së treti, Strategjia fokusohet në Republikën e Kosovës dhe synon të ofrojë një analizë preliminare të nivelit të lartë, të ekspozimit të sektorit financiar ndaj rreziqeve fizike dhe të tranzicionit klimatik për të shpjeguar seriozitetin e mundshëm të këtyre rreziqeve. Së katërti, dokumenti paraqet praktikatat aktuale të sektorit bankar në menaxhimin e rreziqeve klimatike, siç dëshmohet nga Anketa e kryer nga BQK-ja gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 me një numër të kufizuar bankash për të kuptuar më mirë gjendjen aktuale të sektorit. Së fundi, Strategjia përcakton parimet që mbështesin udhërrëfytyesin dhe identifikon veprimet specifike që në pesë fusha (Rregullativë, Mbikëqyrje Bankare, Stabilitet Financiar, Angazhim Kombëtar/Ndërkombëtar dhe Kulturë/Njohuri) do të kryhen gjatë periudhës 2025-2027. BQK-ja pret që veprimet e parapara në Strategji do të çojnë në një përmirësim dramatik në kuptimin dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me klimën nga ana e bankave.

Përmbledhje ekzekutive

Ekziston një konsensus i qartë ndërkombëtar për nevojën për të minimizuar ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike përmes veprimeve zbutëse dhe përshtatëse, dhe Republika e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj ndaj këtij qëllimi. Edhe pse Kosova nuk ka marrë pjesë dhe nuk ka nënshkruar Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) as Protokollin e Kiotos apo Marrëveshjen e Parisit (për shkak se nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara), zotimet e Republikës së Kosovës për mjedisin janë në përputhje me strategjinë e BE-së, pasi Republikës së Kosovës iu dha statusi potencial kandidat për anëtarësim në BE. Republika e Kosovës ishte një nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor që nënshkruan Deklaratën e Sofjes (nëntor 2020), ku vendet pranuan Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane.³, si një gur themeli për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB). Kjo agjendë përfshinë disa zotime që shkojnë shumë përtej zbutjes dhe përshtatjes të ndryshimeve klimatike mbi: (i) klimën, energjinë dhe lëvizshmërinë, (ii) ekonominë qarkore, (iii) çndotjen, (iv) bujqësinë e qëndrueshme dhe prodhimin e ushqimit dhe (v) biodiversitetin.

Përveç të gjitha zotimeve që dalin nga agjenda ndërkombëtare dhe ajo e BE-së, Republika e Kosovës i është përkushtuar agjendës klimatike pasi është dukshëm e ekspozuar ndaj ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike. Në përmbushjen e kësaj agjende, sektori financiar do të luajë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e kalimit në modelin e ri të rritjes së qëndrueshme të mishëruar në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane (dhe kontributet e përcaktuara kombëtare vullnetare që do të zhvillohet), por edhe në minimizimin e efekteve të rreziqeve fizike me identifikimin dhe zbatimin e duhur në kornizën e tyre të rrezikut. Kapitali privat ka të ngjarë të jetë i domosdoshëm për të mbuluar nevojat e mëdha financiare që do t'i nevojiten ekonomisë kosovare në mënyrë që të përmbushë zotimet e saja ndërkombëtare në sektorët e ndryshëm ekonomikë. Duke marrë parasysh rolin dominues që luan sektori bankar kosovar në ndërmjetësimin financiar, bankat janë çelësi për gjelbërimin e sektorit financiar. Autoritetet e BE-së kanë njohur rolin mbizotërues të sektorit financiar në Strategjinë e Rinovuar të Financave të Qëndrueshme (më 6 korrik 2021), që synon të reformojë sektorin financiar dhe ta bëjë atë një pjesë kyçe të zgjidhjes drejt një ekonomie më të gjelbër dhe më të qëndrueshme⁴.

Një pyetje e drejtë ka të bëjë me përcaktimin e rolit që duhet të luajë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në kalimin drejt një ekonomie më pak intensive në karbon. Vendosja e një rruge tranzicioni drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe përafrimi me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane nuk është detyrë e mbikëqyrësve bankarë, as përcaktimi i një sistemi klasifikimi (taksonomie) të aktiviteteve ekonomike që duhet të identifikohen si të gjelbra ose të qëndrueshme. Qëllimet dhe strategjitë kombëtare duhet të përcaktohen nga institucionet dhe subjektet e tjera shtetërore. Megjithatë, rreziqet e ndryshimeve klimatike mund të rezultojnë në rreziqe fizike dhe të tranzicionit që mund të ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e bankave individuale dhe të kenë implikime më të gjera të stabilitetit financiar për sistemin

³ Marrëveshja e Gjelbër Evropiane (EGD) e lansuar në dhjetor 2019 paraqet një strategji të bashkërenduar për ekonominë neutrale ndaj klimës, efikase në burime dhe konkurruese për Evropën. EGD synon të transformojë ekonominë e BE-së në një ekonomi më të qëndrueshme dhe të trajtojë sfidat klimatike dhe mjedisore. EGD është gjithashtu pjesë integrale e strategjisë së Komisionit Evropian për të zbatuar Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në këtë kontekst, nëpërmjet EGD-së, vendet e BE-së u angazhuan për të arritur zero emetime neto të GS deri në vitin 2050 dhe për t'i zvogëluar ato për të paktën 55% deri në vitin 2030 në krahasim me nivelet e vitit 1990. EGD nuk është vetëm një strategji e nivelit të BE-së për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, por gjithashtu një udhërrëfyes drejt një modeli të ri të rritjes ekonomike të qëndrueshme, ku rritja është më pak e varur nga përdorimi intensiv i burimeve natyrore. EGD është ndërtuar rreth një sërë fushash politikash, sektorësh prioritarë dhe temash ndërsektoriale.

⁴ Strategjia e rinovuar bazohet në Planin fillestar të Veprimit të Komisionit Evropian 2018 për Financimin e Rritjes së Qëndrueshme, i cili vendosi themelet për kanalizimin e kapitalit privat drejt investimeve të qëndrueshme. Plan i Veprimit synon: (i) të riorientojë flukset e kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme, (ii) të menaxhojë rreziqet financiare që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, burimet e varfëruara, degradimi i mjedisit dhe çështjet sociale dhe (iii) të nxisë transparencën dhe aspektin afatgjatë në aktivitetin financiar dhe ekonomik.

bankar. Për të adresuar rreziqet financiare të lidhura me klimën brenda sektorit financiar, qëllimi kryesor i BQK-së është të sigurojë që bankat, IFJB-të dhe kompanitë e sigurimeve të identifikojnë, të qeverisin, të matin, të menaxhojnë dhe të kontrollojnë siç duhet rreziqet që lidhen me klimën. Në të njëjtën kohë, BQK-ja duhet të jetë në gjendje të kuptojë ndikimin që mund të kenë këto rreziqe në profilin e rrezikut të bankës përmes analizës së ndjeshmërisë ose të skenarit ose stres testeve, ndër të tjera. Me fjalë të tjera, roli i BQK-së nuk duhet të jetë inkurajimi aktiv i rrjedhave financiare drejt investimeve më të qëndrueshme, por krijimi i një kornize rregullative dhe mbikëqyrëse për të siguruar që rreziqet klimatike të adresohen siç duhet nga sistemi financiar.

Megjithatë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si një subjekt i vetëm në grupin e subjekteve kompetente shtetërore, institucioneve dhe autoriteteve, nuk mund të kontribuojë në prioritetet e miratuara të tranzicionit industrial dhe politikës industriale pa një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka shqyrtuar dhe rishikuar zhvillimet më relevante rregullatore dhe mbikëqyrëse ndërkombëtare në këtë fushë me qëllim të identifikimit të praktikave më të mira aktuale. Duke pasur parasysh përkushtimin ndaj Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, fokus i veçantë i është kushtuar praktikave rregullatore dhe mbikëqyrëse evropiane. Kjo Strategji është hapi i parë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për të trajtuar çështjen e rëndësisë së rreziqeve të lidhura me klimën për sektorin financiar. Ajo gjithashtu konsideron nevojën për koordinim dhe bashkëpunim të brendshëm me institucionet e tjera shtetërore dhe entitete pasi disa elementë kyç të çështjeve të lidhura me klimën (taksonomia e gjelbër ose kërkesat për shpalosjet jofinanciare të korporatave), nuk janë nën kompetencën e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Strategjia gjithashtu synon të ofrojë një pasqyrë fillestare të ekspozimit të sektorit bankar të Republikës së Kosovës ndaj rreziqeve të lidhura me klimën. Edhe pse në fund të fundit do të kërkohet një qasje më gjithëpërfshirëse, largpamëse, e bazuar në analiza të skenarëve të shumëfishtë, edhe pse janë ndërmarrë veprime për të kuptuarit paraprak në nivel të përgjithshëm të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

Analiza paraprake e ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut të tranzicionit tregon se më pak se gjysma e totalit të kredive për sektorin privat (ndërmjet 41.7% dhe 43.9% në 5 vitet e fundit) i është dhënë sektorëve ekonomikë të ndjeshëm ndaj klimës, veçanërisht për sektorin e "patundshmëri" (ekspozimi total është ndërmjet 14% dhe 18,4% me një trend në rënie në dy vitet e fundit), "me energji intensive" (midis 7,6% dhe 9,6% gjatë 5 viteve të fundit), "transportit" (ndërmjet 7.3% dhe 8.0% me luhatje të lehta gjatë periudhës së vëzhguar) dhe në një masë më të vogël "industrive të karburanteve fosile", "bujqësisë" dhe "shërbimeve komunale" (me një peshë të kombinuar ndërmjet 10.0% dhe 11.1% gjatë periudhës). Këtu ekspozimi shprehet ndaj sektorëve ekonomikë që perceptohen si më të ndjeshëm ndaj rreziqeve të tranzicionit që mund të sjellin politikat e reja, zhvillimet teknologjike ose ndryshimet socio-ekonomike. Si rezultate paraprake, ato duhet të kuptohen si të kufizuara dhe për këtë arsye të konsiderohen me kujdes. Një pasqyrë e parë e ekspozimit të bankave ndaj sektorëve më të ndjeshëm.

Rreziku i tranzicionit ofron vetëm një dimension të rreziqeve të lidhura me klimën ndaj të cilave është i ekspozuar sektori financiar, pasi edhe rreziqet fizike janë gjithashtu të rëndësishme. Lidhur me këtë, sipas FMN-së⁵, parashikimet për rajonin e Ballkanit Perëndimor tregojnë ngrohje rajonale më të lartë se mesatarja botërore, veçanërisht për zonat malore, duke rezultuar në një ulje të reshjeve të përgjithshme vjetore, por në të kundërtën me rritje të

⁵ Kërkesa për marrëveshje stand-by dhe një marrëveshje në kuadër të instrumentit për reziliencë dhe qëndrueshmëri (resilience and sustainable facility) – Letër vlerësimi i Bankës Botërore për instrumentin për reziliencë dhe qëndrueshmëri, 10 maj 2023

reshjeve dimërore. Në Kosovë, kjo mund të rezultojë në një rënie prej 50 ditësh në vit të mbulueshmërisë me borë deri në vitin 2050⁶, dhe me përmytje pranverore më të shpeshta. Bazuar në parashikimet e temperaturave më të larta, rritjes së popullsisë dhe uljes së reshjeve vjetore, katër nga pesë pellgje ujore në Kosovë mund të bëhen me stres ujor ose me më pak ujë deri në vitin 2050. Këto rreziqe fizike në mënyrë indirekte, përmes ekonomive familjare dhe bizneseve, do të ndikojnë në profilin e rrezikut të sektorit bankar⁷.

Ekspozimi i sektorit financiar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën është një element i rëndësishëm për stabilitetin financiar të sektorit financiar. Një tjetër element është gatishmëria e bankave për të njohur, inkorporuar dhe menaxhuar këto rreziqe dhe ekspozime. Si pjesë e përgatitjes së Strategjisë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka bërë gjithashtu një përmbledhje të praktikave aktuale të menaxhimit për rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin. Për këtë qëllim, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës përgatiti dhe dërgoi në disa banka një anketë gjithëpërfshirëse për një kuptueshmëri të plotë të praktikave të tyre. Nga analiza e përgjigjeve, u evidentua se bankat, ndërkohë që janë në një fazë fillestare, kanë bërë një progres të pabarabartë në këtë fushë. Ato që kanë ndërmarrë më shumë veprime në terren janë kryesisht filiale nga grupet bankare të BE-së, duke adoptuar politikat e grupit. Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë zhvilluar produkte të gjelbra si për korporatat ashtu edhe për individët, në disa raste të ndikuar nga institucionet financiare ndërkombëtare ose nga programet kombëtare të financimit. Në fund, bankat e anketuara nënvizuan gjithashtu nevojën për të rritur ndjeshëm përpjekjet e tyre në përmirësimin e praktikave të tyre të qeverisjes dhe menaxhimit, për çka ata inkurajojnë BQK-në që t'u ofrojë atyre udhëzime dhe/ose rregullore se si bankat duhet të menaxhojnë rreziqet e tyre të lidhura me klimën.

Në këtë kuptim, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka përgatitur, me mbështetjen e FinSAC, një Strategji shumëvjeçare (2025-2027) që bazohet në 10 parime (të paraqitura në Figura 1) për trajtimin e rreziqeve klimatike, në katër grupe të aktiviteteve.

Figura 1: Lista e parimeve mbi të cilat bazohet Strategjia



⁶ USAID (2017). Profili i rrezikut nga ndryshimet klimatike për Kosovën

⁷ Do të nevojiten më shumë informacione për rreziqet fizike përgjatë zonave gjeografike të Republikës së Kosovës për të kryer një analizë më të thellë

Të gjitha aktivitetet e parashikuara nga kjo strategji për periudhën 2025-2027 dhe të përfshira në udhërrëfyese klasifikohen në grupet e mëposhtme (shih Figura 2):

- **Veprimet rregullatore**, duke përfshirë nxjerrjen e rekomandimeve/udhëzimeve (letër këshilluese) ose rregulloreve për qeverisjen, vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve të lidhura me klimën, ose veprime të tjera rregullatore (ndryshime të qeverisjes korporative, shpalesjes, rregulloreve të ICAAP, etj.).
- **Veprimet mbikëqyrëse**. Pasi të jenë vendosur rekomandimet/udhëzimet (letra këshilluese), BQK-ja do të ndërmarë veprimet e nevojshme për të vlerësuar pajtueshmërinë e bankave me kërkesat e reja, do të përditësojë Mbikëqyrjen e bazuar në Rrezik dhe metodologjitë e tjera të vlerësimit që përdoren nga mbikëqyrësit në punën e tyre të përditshme .
- **Veprimet e stabilitetit financiar**. Vlerësimi i BQK-së për ndikimin e mundshëm të rreziqeve të lidhura me klimën në stabilitetin financiar të Republikës së Kosovës. Aktivitetet e BQK-së do të përfshijnë gjithashtu vlerësimin dhe të kuptuarit e plotë të ekspozimit të bankave ndaj rreziqeve klimatike duke përdorur analizën e skenarëve dhe, kur është e aplikueshme, stres testin.
- **Angazhimi kombëtar dhe ndërkombëtar**. BQK-ja do të marrë pjesë në forume rajonale dhe ndërkombëtare për zgjerimin e ekspertizës dhe njohurive në këto fusha. BQK-ja angazhohet me autoritetet e tjera lokale përgjegjëse për ndryshimet klimatike (veçanërisht të rëndësishme për Taksonomitë e Gjelbra).
- **Kultura / njohuritë**. Sipas kësaj rrjedhe të punës, BQK-ja do të pritët të zhvillojë një vlerësim të qëndrueshmërisë së aktiviteteve të zhvilluara nga vetë BQK-ja dhe aktiviteteve kërkimore. BQK-ja gjithashtu do të angazhohet rregullisht me universitetet.

Figura 2: Udhërrëfytyesi 2025-2027



1. Rëndësia në kontekstin e Republikës së Kosovës

Në nëntor të vitit 2020, Republika e Kosovës ishte një nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor⁸ që miratoi Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor⁹ në Samitin e Sofjes në nëntor 2020, duke u zotuar për qëllime ambicioze mjedisore dhe klimatike, të strukturuar në pesë shtylla: (1) klima, energjia, dhe mobiliteti; (2) ekonomia qarkore; (3) çndotja; (4) bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; dhe (5) biodiversiteti. Megjithatë, zbatimi shpesh mungon për shkak të kostove (të perceptuara) financiare, ekonomike dhe sociale të proceseve të transformimit, interesave të ndryshme të akterëve social, hendeikut të informatave në mes të vendimmarrësve dhe kundërshtimit nga interesat e caktuara.

Disa nga komponentët kryesorë nga zotimet e Ballkanit Perëndimor për ndryshimet klimatike përfshijnë¹⁰:

- Përafrimin me Legjislacionin e BE-së për Klimën pasi të miratohet, me vizionin për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.
- Vendosjen e objektivave parashikuese klimatike për vitin 2030 në përputhje me acquis të BE-së, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integruara klimatike me masa të qarta të dizajnuara për të reduktuar emetimet e gazrave serrë në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duke integruar veprimet klimatike në të gjitha politikat përkatëse sektoriale.
- Përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të përshtatjes klimatike për të rritur qëndrueshmërinë përmes investimeve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të siguruar një integrim më të madh të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike me reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.
- Vazhdimin e harmonizimit me Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE-së, si dhe punën drejt futjes së instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit për të promovuar dekarbonizimin në rajon.
- Rritjen e mundësive për vendosjen e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të zbutur dhe përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike.
- Përpjekjet për të ulur dhe hequr gradualisht subvencionet e thëngjillit, duke respektuar rreptësisht rregullat e ndihmës shtetërore.

Përveç zotimeve të mësipërme, dhe pavarësisht se nuk është kërkesë pasi që Republika e Kosovës nuk është pjesë e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike e as Protokollit të Kiotos apo Marrëveshjes së Parisit, Republika e Kosovës ka nisur në vitin 2021 një diskutim me palët e interesuara ndërkombëtare për të përgatitur Kontributet e Përcaktuara Kombëtare vullnetare, që do të bazohet në planin e Kosovës për të reduktuar emetimet e gazrave serrë me 8.95 Mt CO₂e deri në vitin 2030. Ky është një reduktim prej afërsisht 16.3% krahasuar me nivelet e vitit 2016. Përveç kësaj, Kosova po planifikon të rrisë pjesën e energjisë së ripërtëritshme në miksin e energjisë në 32% deri në vitin 2030. Në fund, Kontributet e Përcaktuara Kombëtare vullnetare do të përfshijë gjithashtu masa përshtatëse në sektorë të tjerë relevantë në luftimin e ndryshimeve klimatike, përkatësisht: uji; bujqësia, pylltaria, dhe përdorimi tjetër i tokës, uji; biodiversiteti; dhe shëndeti.

Përkundër sipërfaqes relativisht të vogël të Republikës së Kosovës, vendi ka një klimë të larmishme, me tre rajone të diferencuara¹¹:

⁸ Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Republika e Serbisë

⁹ <https://www.rcc.int/docs/596/action-plan-for-the-implementation-of-the-sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-2021-2030>.

¹⁰ <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>

¹¹ <http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/en/kosovo/climate.html>

- Nga njëra anë, veriu i Kosovës ndikohet nga masa ajrore kontinentale, duke u karakterizuar me dimra të ftohtë, me temperatura mesatare mbi $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$, por ndonjëherë deri në $-26\text{ }^{\circ}\text{C}$. Nga ana tjetër, verërat janë jashtëzakonisht të ngrohta me temperatura mesatare prej $20\text{ }^{\circ}\text{C}$, ndonjëherë deri në $37\text{ }^{\circ}\text{C}$. Këtë rajon e karakterizon klima e thatë dhe reshjet prej rreth 600 mm në vit.
- Nga ana tjetër, rajoni i Dukagjinit është i ndikuar nga masat e nxehta ajrore që vijnë nga deti Adriatik. Temperaturat mesatare gjatë dimrit variojnë nga $0,5\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri ndonjëherë në $22,8\text{ }^{\circ}\text{C}$. Reshjet mesatare vjetore janë afër 700 mm në vit, dhe dimri karakterizohet me reshje të dendura bore.
- Në fund, zonat malore dhe pyjore karakterizohen nga reshje të dendura, midis 900 dhe 1,300 mm në vit, verëra të shkurtra dhe të ftohta dhe dimra të ftohtë dhe me borë.

Përkundër zvogëlimin të rëndësisë relative në sektorin e bujqësisë për sa i përket BPV-së që nga vitet 1980-ta dhe fillimi i viteve 1990-ta (me përafërsisht 25% të BPV-së së vendit), ai ende përfaqëson një përqindje relativisht të lartë të BPV-së në Kosovë, në 7.4% në vitin 2020. Sektori i bujqësisë gjithashtu zë 16.4% (2020¹²) të vlerës totale të eksportit dhe mbetet një sektor i rëndësishëm ekonomik. Në anën tjetër, Kosova ende varet shumë nga produktet bujqësore të importuara, të cilat përbëjnë 23.2% të importeve të përgjithshme. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore vlerësohet të jetë rreth 43,7% ose (470,400 ha). Bazuar në informacionin e fundit të Anketës së Ekonomive Bujqësore 2014, rreth 80.8% (413,635 ha) e kësaj toke është tokë e punueshme dhe rreth 14% ose (65,856 ha) llogaritet si kullosa. Sektori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Përdorimit të Tokës përbën rreth 13% të emetimeve totale të GS-ve në Kosovë. Ky sektor përbëhet nga tre nënsektore të veçantë. Blegtoaria, si nënsektor i parë, gjeneron çdo vit rreth 600 mijë ton CO_2 ekuivalent. Nënsektori i përdorimit të tokës dominohet nga pylltaria, e cila mund të jetë një absorbues i fuqishëm i karbonit atmosferik. Por për sa i përket karbonit që kalon çdo vit në këtë nënsektor, është sektori i dytë më i madh në vend me rreth 2,750 mijë tonë CO_2 . Inventari i mirë i pyjeve dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve mund të kontribuojnë shumë në uljen e emetimeve. Dhe nënsektori i tretë, ku emetimet e kësaj kategorie kanë të bëjnë me menaxhimin e plehut organik dhe plehërimin e kulturave, i cili në total emeton rreth 800 mijë ton të CO_2 ekuivalent.

Kosova ka sasi relativisht të vogla dhe të kufizuara të burimeve të ujërave të ëmbla. Për më tepër, burimet ujore të disponueshme janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në të gjithë territorin, të ndara në katër pellgje lumore/pellgje ujëmbledhëse. Furnizimi mesatar vjetor i ripërtëritshëm me ujë për person në Kosovë është rreth $1,987\text{ m}^3/\text{person}/\text{vit}$ dhe kategorizohet si pa stres sipas treguesit Falkenmark, që është ndjeshëm më ulët në krahasim me mesataren botërore prej $7,243\text{ m}^3$.¹³ Kategoritë kryesore të përdorimit të burimeve të ujit të ëmbël janë: Furnizimi me ujë të pijshëm për ekonomi familjare, furnizimit me ujë për Industrinë dhe Energjetikën (për hidroenergjinë dhe për ftohje të termocentraleve) dhe për qëllime të ujitjes. Bazuar në Raportin Vjetor të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë për vitin 2012, industria e ujit në Kosovë është ende e dobët; duke treguar mangësi në shumicën e treguesve të performancës të tilla si mbulimi i shërbimit që është në nivel prej 78%. Shumë fshatra rurale nuk mbulohe nga skemat rajonale të furnizimit me ujë dhe disa fshatra ende përdorin ujërat nëntokësore nga pusët e cekëta me cilësi të përkeqësuar.

Energjia elektrike në Kosovë prodhohet kryesisht nga lëndë djegëse fosile, kryesisht thëngjilli, që përdoret për të gjeneruar më shumë se 90 përqind të energjisë elektrike të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prodhohet nga parqet me erë, hidro-gjenerimi dhe në një masë të vogël nga parqet solare. Përdorimi i gazit natyror është praktikisht inekzistent, pa rrjet shpërndarjeje për

¹² Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)

¹³ CEDARE AWC, 2006

konsumatorët rezidencialë ose komercialë. Gjithashtu nuk ka as qendra vendore ku bëhet rafinimi i naftës; rrjedhimisht, importet e naftës janë kryesisht produkte të rafinuara. Kështu, inventari i GS 2019 identifikoi sektorin e energjisë si burimin e emetimeve më të larta me 86% të emetimeve totale të GS-ve të vlerësuara në 9,613 Gg të CO² ekuivalent. Megjithatë, në krahasim me vendet e tjera të Evropës, Kosova ka emetime relativisht të ulëta për kokë banori (5 ton të CO₂ ekuivalent për kokë banori në vit), ndërsa emetimet e GS për njësi të BPV-së (0.5 kg të CO₂ ekuivalent për EUR) janë më të larta¹⁴.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2018-2027, të zhvilluar në vitin 2018 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në Kosovë, disa nga ndikimet kryesore të ndryshimeve klimatike në Kosovë përfshijnë si në vijim¹⁵:

- Ekspozimi ndaj rreziqeve të tilla si thatësitrat, përmytjet dhe zjarret në pyje do të bëhen më të mëdha, me ndryshimet klimatike. Ndryshueshmëria e klimës është rritur tashmë edhe në Kosovë.
- Rritja e intensitetit dhe shpeshtësisë së reshjeve ekstreme siç janë shirat e dendur, si dhe thatësitrat edhe më të rënda, veçanërisht nga vitet e '80-ta. Përmytjet e menjëhershme po bëhen gjithnjë e më të rëndomta në viset malore, gjersa vërshimet e lumenjve po ndodhin gjithnjë e më shpesh në fusha dhe zona të ulëta.
- Temperaturat më të larta më me gjasë do të shkaktojnë valë të nxehta dhe zjarre në pyje. Që nga viti 2000 e tutje në Kosovë ka pasur gjithnjë e më shumë zjarre në pyje.
- Kosova disa herë është goditur nga thatësitrat gjatë dy dekadave të fundit (1993, 2000, 2007, 2009 dhe 2012).
- Temperaturat e ngritura, reshjet e pakësuara dhe zvogëlimi i rrjedhave në kombinim me zhvillimet socio-ekonomike dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ujit, do ta rrisin ekspozimin në thatësira.
- Ekspozimi ndaj përmytjeve, si në janar 2021, i shkaktuar nga reshjet e dendura dhe shtimi i shkrirjes së borës për shkak të rritjes së papritur të temperaturës.
- Degradimi i ekosistemit dhe zvogëlimi i shërbimeve të ekosistemit.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka intensifikuar punën e saj në këtë fushë dhe kjo strategji shumëvjeçare është një nga hapat në inkorporimin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorët bankarë.

2. Rreziqet financiare të lidhura me klimën në arenën ndërkombëtare

2.1. Iniciativat rregullatore për rreziqet financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar

Ndryshimet klimatike janë problem global që bota po përpiqet ta zgjidhë përmes reduktimit të emetimeve të CO₂ dhe GS-ve të tjera, kryesisht në sektorin e energjisë, duke konsumuar më pak lëndë djegëse fosile (thëngjill termik, naftë dhe gaz) ose duke i zëvendësuar ato me burime të rinovueshme/alternative të energjisë. Veprimet e politikave të ndërmarra në mbarë botën rezultojnë në rreziqe fizike dhe të tranzicionit për bankat dhe institucionet e tjera financiare. Megjithatë, ndryshimet klimatike nuk janë rreziku i vetëm mjedisor ndaj të cilit janë të ekspozuara drejtpërdrejt ose tërthorazi bankat, ka edhe ndotje të ajrit, veçanërisht në qytete, ndotje të ujit, mungesë riciklimi, humbje të biodiversitetit për shkak të dëmtimit të pakthyeshëm të ekosistemeve dhe rreziqe të tjera. Prandaj, bankat janë të ekspozuara ndaj humbjeve fizike të lidhura me ngjarjet më të shpeshta akute (thatësitrat, valët e të nxehtit, ciklonet, stuhitë, etj.) ose ngjarjet ekstreme kronike të motit (rritja e nivelit të detit, rritja e temperaturave mesatare, zvogëlimi i reshjeve, etj.) që mund të rezultojnë në humbje direkte

¹⁴ Kërkesa për marrëveshje stand-by dhe marrëveshje në kuadër të instrumentit për reziliencë dhe qëndrueshmëri (resilience and sustainable facility) – Letër vlerësimi i Bankës Botërore për programin për reziliencë dhe qëndrueshmëri, 10 maj 2023

¹⁵ IPCC, 2007, 2013, UN-Habitat 2009, OSBE 2008, UNDP/WMO 2009, dhe të tjera

ose indirekte për bankën. Veprimet e politikave strikte, zhvillimet teknologjike ose preferencat e konsumatorëve që ndryshojnë me shpejtësi mund të rezultojnë gjithashtu në humbjen e vlerës së asetëve të caktuara (asetet e bllokuara) që ndikojnë në aktivitetet e bankës (rreziqet e tranzicionit).

Në këtë drejtim, rregullatorët dhe mbikëqyrësit prudencialë në mbarë botën kanë ndërmarrë veprime të vendosura me një qëllim të dyfishtë: (i) të sigurojnë që bankat të kuptojnë, qeverisin, identifikojnë, menaxhojnë dhe kontrollojnë siç duhet rreziqet e lidhura me klimën ndaj të cilave ato janë të ekspozuara dhe (ii) që mbikëqyrësit të jenë në gjendje të matin siç duhet profilin e rrezikut të klimës, veçanërisht në skenarët klimatike ku janë projektuar shtigjet klimatike. Debati rreth ndikimit që mund të ketë ndryshimi klimatik në bilancet e institucioneve financiare u identifikua fillimisht nga Mark Carney, ish-gubernator i Bankës së Anglisë, në shtator 2015¹⁶.

Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse kanë ndërmarrë veprime të shumta në këtë fushë. Institucionet evropiane kanë vepruar si pionierë në plotësimin gjithëpërfshirës të pritjeve mbikëqyrëse që bankat pritet të përmbushin kur menaxhojnë rreziqet e lidhura me klimën. Në këtë drejtim, Banka e Anglisë ishte institucioni i parë që në prill të vitit 2019 nxori Udhëzuesin për Menaxhimin e Rreziqeve të Bankës nga Ndryshimet Klimatike¹⁷. Një moment historik shumë i rëndësishëm erdhi me publikimin e një udhëzuesi gjithëpërfshirës nga BQE mbi rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin në nëntor të vitit 2020¹⁸ (Shih Figura 3 më poshtë me pritshmëritë për bankat e listuara në Udhëzues). Mbikëqyrësit e tjerë të BE-së gjithashtu kanë nxjerrë pritshmëritë dhe/ose rekomandimet e tyre për menaxhimin e këtyre rreziqeve¹⁹.

¹⁶ Fjalimin mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm <https://www.bankofengland.co.uk/speech/2015/breaking-the-tragedy-of-the-horizon-climate-change-and-financial-stability>.

¹⁷ <https://www.bankofengland.co.uk/prudential-regulation/publication/2019/enhancing-banks-and-insurers-approaches-to-managing-the-financial-risks-from-climate-change-ss>. Banka e Anglisë vazhdoi me një letër të llojit 'I' nderuar Kryeshef Ekzekutiv (CEO) drejtuar bankave ku kërkoi më shumë veprime nga bankat në këtë fushë

¹⁸ <https://www.bankingsupervision.europa.eu/ecb/pub/pdf/ssm.202011finalguideonclimate-relatedandenvironmentalrisks~58213f6564.en.pdf>. Udhëzuesi është nxjerrë për konsultim publik fillimisht në maj 2020.

¹⁹ Shih për shembull Bankën Kombëtare të Hungarisë "Rekomandimi 47/2021 (IV.14) i Bankës Magyar Nemzeti për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin dhe integrimin e konsideratave të qëndrueshmërisë mjedisore në aktivitetet e institucioneve kreditore". Rekomandimi është përditësuar gjatë verës së vitit 2022: "Rekomandimi Nr. 10/2022 (VIII.2) i Bankës Magyar Nemzeti për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin dhe integrimin e konsideratave të qëndrueshmërisë mjedisore në aktivitetet e institucioneve kreditore"

Figura 3: Pritshmëritë e BQE-së për bankat²⁰



Përfundimisht, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (BCBS) në qershor 2022 publikoi versionin përfundimtar të Parimeve të tyre për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Efektive të Rreziqeve të Klimës²¹, siç është paraqitur në Kutinë 1 më poshtë.

²⁰ Udhëzues për rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin: Pritjet mbikëqyrëse në lidhje me menaxhimin dhe zbulimin e rrezikut, Nëntor 2020

²¹ <https://www.bis.org/bcbs/publ/d532.htm>. Drafti version u lëshua për konsultim në nëntor 2021

Kutia 1: Parimet e BCBS për menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive të rreziqeve financiare të lidhura me klimën

Duke qenë se ndryshimi klimatik mund të rezultojë në rreziqe fizike dhe të tranzicionit që mund të ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve bankare individuale dhe të kenë implikime më të gjera të stabilitetit financiar për sistemin bankar, në vitin 2020 Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (BCBS) krijoi një grup të nivelit të lartë për të kontribuar në forcimin e rregullativës, mbikëqyrjes dhe praktikave të bankave në mbarë botën për rreziqet klimatike me qëllim rritjen e stabilitetit financiar.

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (BCBS) kreu një analizë të hendeqeve potenciale në Kornizën e Bazelit dhe shqyrtoi masat e mundshme për adresimin e këtyre hendeqeve. Analiza tregoi se Parimet Themelore për Mbikëqyrjen Efektive Bankare (BCP) dhe Procesi i Rishikimit Mbikëqyrës (SREP) janë mjaft të gjera dhe fleksibël për të akomoduar përgjigjet shtesë mbikëqyrëse ndaj rreziqeve financiare të lidhura me klimën. Megjithatë, në qershor të vitit 2022 Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (BCBS) përgatiti dhe publikoi Parimet për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Efektive të rreziqeve financiare të lidhura me klimën, në mënyrë që të promovojë një qasje të bazuar në parime për përmirësimin e menaxhimit të rrezikut dhe praktikave mbikëqyrëse në lidhje me rreziqet financiare të lidhura me klimën.

Dokumenti përfshinë 18 parime të nivelit të lartë, 12 prej të cilave u ofrojnë bankave udhëzime për menaxhimin efektiv të rreziqeve financiare të lidhura me klimën, dhe 6 prej tyre parashtrojnë rekomandime për mbikëqyrësit prudencialë. Parimet synojnë të arrijnë një ekuilibër në përmirësimin e praktikave që lidhen me menaxhimin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën dhe të ofrojnë një bazë të përbashkët për bankat dhe mbikëqyrësit ndërkombëtarë aktivë, duke ruajtur njëkohësisht fleksibilitet të mjaftueshëm duke pasur parasysh shkallën e heterogjenitetit dhe praktikat në zhvillim në këtë fushë.

Parimet për menaxhimin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën mbulojnë:

- Qeverisjen korporative (3 parime).
- Kornizën e kontrollit të brendshëm (1 parim).
- Mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit (1 parim).
- Procesin e menaxhimit të rrezikut (1 parim).
- Monitorimin dhe raportimin e menaxhimit (1 parim).
- Menaxhimin gjithëpërfshirës të rrezikut kreditor (1 parim).
- Menaxhimin gjithëpërfshirës të tregut, likuiditetit, rreziqeve operacionale dhe të tjera (3 parime).
- Analizën e skenarit (1 parim).

Parimet për mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën përfshijnë:

- Kërkesat prudenciale rregullatore dhe mbikëqyrëse për bankat (3 parime).
- Përgjegjësitë, kompetencat dhe funksionet e mbikëqyrësve (3 parime).

Autoritetet gjithashtu kanë avancuar në inkorporimin e rreziqeve të lidhura me klimën dhe, më gjerësisht, rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) në sistemin e vlerësimit të SREP (Procesi i Rishikimit Mbikëqyrës). "Raporti i Autoritetit Bankar Evropian mbi Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen e Rrezikut të ESG (mjedisor, social dhe të qeverisjes), sipas nenit 98(8) të CRD dhe nenit 35 të IFD" ka qenë një zhvillim kyç. Në këtë dokument, Autoriteti Bankar Evropian përshkruan se si ESG duhet të integrohet në strategjinë e biznesit të bankave, aranzhimet e

qeverisjes dhe menaxhimin e rrezikut²². Autoriteti Bankar Evropian pritet gjithashtu të përditësojë Udhëzimet e SREP për të përfshirë rreziqet e ESG. Për më tepër, Autoriteti Bankar Evropian kishte zbatuar edhe një rregullore që u kërkon bankave të integrojnë qëndrueshmërinë në të gjitha vendimet e tyre për lejimin e kredive dhe monitorimin e kredive për klientët e tyre të korporatave dhe të NVM-ve.²³ Zhvillimi nga autoritetet evropiane lidhur me Procesin e Rishikimit Mbikëqyrës (SREP) është kyç për Republikën e Kosovës, pasi korniza mbikëqyrëse në masë të madhe pasqyron atë evropiane.





Bankat qendrore dhe mbikëqyrësit në mbarë botën kanë përmirësuar gjithashtu pakon e mjeteve për të matur ekspozimin e institucioneve financiare ndaj rreziqeve klimatike. Analiza e skenarëve dhe stres testet janë gjithnjë e më të popullarizuara tek autoritetet.


Megjithatë, stres testet klimatike nuk janë ushtrime tradicionale. Së pari, horizonti kohor është zakonisht shumë më i gjatë, pasi ndikimet më të thella negative të rreziqeve klimatike pritet të ndodhin në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Së dyti, autoritetet përdorin një numër më të madh skenarësh, duke reflektuar pasiguritë që rrethojnë rreziqet klimatike. Për shembull, Banka e Holandës (DNB) kreu skenarin e saj të parë makroprudencial mbi rreziqet klimatike në vitin 2018, duke përdorur një horizont 5-vjeçar brenda 4 skenarëve të ndryshëm (shtigjet klimatike) për rreziqet e tranzicionit. ACPR (Banque de France) në vitin 2020 ndërmori një stres test klimatik vullnetar me një horizont kohor 30-vjeçar në 4 skenarë, 3 për rreziqet e tranzicionit dhe 1 për rreziqet fizike. Në vitin 2022, si Banka Qendrore e Anglisë (BoE) ashtu edhe Banka Qendrore Evropiane (ECB) kryen stres testin klimatik nga poshtë-lart, për të vlerësuar mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave sipas skenarëve të ndryshëm. Banka Qendrore Evropiane (ECB) përdori horizonte të ndryshme kohore, 1 dhe 3 vjet dhe 30 vjet në 6 skenarë, 4 për rreziqet e tranzicionit dhe 2 për rreziqet fizike. Ndërkohë, Banka Qendrore e Anglisë (BoE) përcaktoi 2 skenarë për rreziqet e tranzicionit dhe 1 për rreziqet fizike deri në një horizont 30-vjeçar për vlerësimin e rreziqeve të tranzicionit. Autoritetet zakonisht përdornin skenarët e përcaktuar nga Rrjeti për Gjelbërimin e Sistemeve Financiare (NGFS) (shih Kutia 2 më poshtë).

²² Edhe pse aktualisht EBA është ende duke planifikuar përgatitjen dhe nxjerrjen e Udhëzimeve të EBA-së për Menaxhimin e Rrezikut të ESG

²³ Këto detyrime janë të përfshira në Udhëzimet e EBA-së për inicimin (origjinën) dhe monitorimin e kredisë, që hynë në fuqi në vitin 2022 për aspekte që lidhen me ESG. Shiko <https://www.eba.europa.eu/regulation-and-policy/credit-risk/guidelines-on-loan-origination-and-monitoring>

Figura 4: Standardi për stres-testet lidhur me klimën²⁴

				
A janë firmat të përfshira në ushtrim?	Po	Jo	Po	Po
Rrezik fizik / tranzicionit	Po / Po	Jo / Po	Po / Po	Po / Po
Periudha kohore	30 vite	5 vite	30 vite	3 & 30 vite
Bilanci gjendjes statik / dinamik	Statik për 5 vitet e para, pastaj riveleshohet çdo 5 vjet	Statike	Statik, me vlerësim të ndikimit çdo 5 vjet	4. Statik - 3 vite; Dinamik - 30 vjet (vlerësimi në vitet 2030/40/50)
Numri i skenarëve	3 për rrezikun e tranzicionit dhe 1 për rrezikun fizik	4 për rrezikun e tranzicionit	2 për rrezikun e tranzicionit dhe 1 për rrezikun fizik	4 për rrezikun e tranzicionit dhe 2 për rrezikun fizik
Ndarja sektoriale	Klasifikimi WIOD	Klasifikimi NACE - 56 sektorë	Kodet SIC	Klasifikimi NACE - 22 sektorë dhe industri të tjera të agreguara
Variabla e synuar	Humbjet nga ana e asetëve (rreziqet kreditore, rreziqet kreditore të kundërpalët dhe rreziqet e tregut)	Humbjet nga ana e asetëve	Zhvlerësimet e librit kreditor	Çvlerësimet kreditore, humbjet nga ana e asetëve (tregut, operacionale) krahas ndikimeve të mundshme që rrjedhin nga çështjet e reputacionit
Ndarja e outputit	Gjeografike, sektoriale, kundërpalët kyçe (top 15)	Rangu i humbjeve në banka, siguruesit, fondet pensionale - CET1 ndikimi për bankat	Gjeografike, sektoriale, ekspozimet kyçe (top 100)	Gjeografike, sektoriale, kundërpalët kyçe (top 20)
Ushtrimi i barazimit	Po	Jo	Po, në një pyetësor të veçantë cilësor	Jo
Komunikimi i rezultateve	BdF / ACPR shpallon rezultatet në gjithë sistemin dhe ofron koment kthyes tek firmat individuale	DNB publikoi një përllogaritje të ndikimit (ndryshimet e agreguara të CET1) në sektorin financiar holandez	BoE shpallë rezultatet në të gjithë sistemin dhe ofron koment kthyes tek firmat individuale	SSM shpallë rezultatet të agreguara dhe ofron koment kthyes tek firmat individuale

 Praktika më e mirë (nëse është e aplikueshme)

Pasqyra e skenarëve të NGFS që autoritetet në mbarë botën po përdorin si pjesë të stres-testeve të tyre janë përcaktuar në Kutia 2. NGFS ka përcaktuar në thelb 4 lloje skenarësh: "tranzicion i rregullt", "tranzicion i çrregullt", "shumë pak, shumë vonë" dhe "botë që i ngjan serrës".

²⁴ Burimet: (i) nxjerrë nga BIS/FSI, "Testimi i stresit të bankave për ndryshimet klimatike – një krahasim i praktikave", korrik 2021; (ii) elaboruar së brendshmi nga Metodologjia e testimit të stresit klimatik të ECB-së, tetor 2021


Kutia 2: Skenarët e Rrjetit për Gjelbërimin e Sistemeve Financiare (NGFS)²⁵

NGFS zhvilloi katër lloje të skenarëve të lidhur me klimën:

1. Skenarët e **rregullt** supozojnë se politikat klimatike janë futur në fuqi herët dhe bëhen gradualisht më të rrepta. Rreziqet fizike dhe të tranzicionit janë relativisht të ulëta.
2. Skenarët e **çrregullt** eksplorojnë rrezik më të lartë të tranzicionit për shkak të politikave të vonuara ose divergjente në vende dhe sektorë. Çmimet e karbonit janë zakonisht më të larta për një rezultat të caktuar të temperaturës.
3. Skenarët e **botës që i ngjan serrës** supozojnë se disa politika klimatike zbatohen në disa juridiksione, por përpjekjet globale janë të pamjaftueshme për të ndaluar ngrohjen e konsiderueshme globale. Janë tejkaluar kufijtë kritik të temperaturës duke çuar në rreziqe të rënda fizike dhe ndikime të pakthyeshme si rritja e nivelit të detit.
4. **Shumë pak, shumë vonë**, është e mundur që një tranzicion i vonuar do të dështonte të frenojë rreziqet fizike. Ndërsa asnjë skenar nuk është projektuar posaçërisht për këtë qëllim, kjo hapësirë mund të eksplorohej duke supozuar rezultate më të larta të rrezikut fizik për skenarët e çrregullt.

Katër llojet e skenarëve më sipër, aktualisht ndahen në gjashtë skenarë të ndryshëm:

1. **Net Zero 2050** është një skenar ambicioz që kufizon ngrohjen globale në 1,5 °C përmes politikave të rrepta klimatike dhe inovacionit, duke arritur emetimet neto zero të CO₂ rreth vitit 2050. Disa juridiksione si SHBA, BE dhe Japonia arrijnë në zero neto për të gjitha gazrat serrë deri në këtë pikë.
2. **Nën 2°C** rritja graduale e rreptësisë së politikave klimatike, duke dhënë një shans 67% për të kufizuar ngrohjen globale nën 2 °C.
3. **Net Zero divergjente** arrin neto-zero deri në vitin 2050, por me kosto më të larta për shkak të politikave divergjente të paraqitura nëpër sektorë dhe largimit gradual më të shpejtë të karburanteve fosile.
4. **Tranzicioni i vonuar** supozon se emetimet vjetore globale nuk do të ulen deri në vitin 2030. Më pas do të nevojiten politika të forta për të kufizuar ngrohjen nën 2°C. Emetimet negative janë të kufizuara.
5. **Kontributet e përcaktuara në nivel kombëtar (NDC)** përfshinë të gjitha politikat e zotuar edhe nëse nuk janë zbatuar ende.
6. **Politikat aktuale** supozon se ruhen vetëm politikat e zbatuara aktualisht, duke çuar në rreziqe të larta fizike.



²⁵Burimi: <https://www.ngfs.net/ngfs-scenarios-portal/>

Rregulloret u kërkojnë bankave të bëjnë shpalosje prudenciale mbi qëndrueshmërinë. Në BE, Rregullorja e Kërkesave të Kapitalit (CRR) u ka kërkuar bankave të bëjnë shpalosje kuantitative dhe kualitative të rrezikut klimatik të Shtyllës 3, për t'u mundësuar investitorëve të vlerësojnë ekspozimin dhe praktikën e menaxhimit të bankave ndaj rreziqeve klimatike²⁶. Në vitin 2017, Task Forca për Shpalosjet e Financave të Lidhura me Klimën (TCFD) lëshoi një raport rekomandimesh, ku identifikoi shpalosjet kryesore që kompanitë financiare dhe jofinanciare duhet të përgatitin, të përditësuar më vonë në tetor të vitit 2021²⁷.

Megjithatë, më pak progres është bërë në integrimin e rreziqeve klimatike në kornizën prudenciale për kërkesat e kapitalit. Debati është ende kryesisht në fillimet e tij dhe aktualisht ka pak marrëveshje se si këto rreziqe duhet të integrohen në regjimin prudencial për kërkesat e kapitalit. Prandaj, është ende herët të merret në konsideratë se si trajtimi i këtyre rreziqeve mund të rrjedhë në një qasje më të standardizuar për kërkesat e kapitalit.²⁸

2.2. Taksonomitë dhe iniciativat e tjera rregullatore

Për zbatimin e praktikave të shëndosha të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut klimatik, bankat mund të mbështeten, të paktën pjesërisht, në punën e organeve dhe autoriteteve të tjera kompetente kosovare. Në mënyrë kritike, agjentët ekonomikë, duke përfshirë por pa u kufizuar në bankat, duhet të kenë një kornizë të qartë dhe të përbashkët për të vendosur kriteret mbi të cilat një aktivitet ekonomik përcaktohet si i gjelbër ose i qëndrueshëm (taksonomia e gjelbër). Një taksonomi e gjelbër e përcaktuar në mënyrë rigoroz mund të jetë gjithashtu bazë për veprime të tjera rregullatore që do të jenë të rëndësishme më të madhe për menaxhimin e rreziqeve të lidhura me klimën, p.sh., korporatave jofinanciare mund t'u kërkohej të shpalosin se si aktivitetet e tyre janë në përputhje me taksonominë e gjelbër.

Në mungesë të një kornize të përbashkët, bankat do të duhet të përdorin përkufizimet e tyre të aktiviteteve të qëndrueshme/të gjelbra, duke minuar krahasimet ndërmjet tyre dhe duke rezultuar potencialisht në praktika të "shpëlarjes së gjelbër" (greenwashing), ku bankat mund të kenë stimul për të mbivlerësuar qëndrueshmërinë e portofolios së tyre.

Përkufizimi i një taksonomie të gjelbër do të jetë shumë përtej mandatit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, pasi një klasifikim kombëtar i qëndrueshmërisë së aktiviteteve ekonomike nuk do të prekë vetëm bankat e mbikëqyrura, por shumë agjentë të tjerë ekonomikë, duke përfshirë korporatat jofinanciare dhe subjektet e sektorit publik. Megjithatë, Banka Qendrore mund të angazhohet me autoritetet dhe organet kompetente të vendit që janë përgjegjëse për zhvillimin e taksonomisë së gjelbër dhe kërkesat për shpalosje të ndërlidhura me të²⁹.

²⁶ Neni 449a i CRR vendosi kërkesa të reja për shpalosjen prudenciale për bankat. Shpalosja mbulon: (i) informacionin mbi rreziqet e tranzicionit klimatik, duke përfshirë ekspozimet ndaj sektorëve me karbon të lartë dhe emetimet e GS të palëve të tyre (ii) informacionin mbi efikasitetin energjetik të pasurive të paluajtshme në kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, (iii) rreziqet fizike klimatike, ekspozimet bankare që i nënshtrohen rreziqeve fizike, (iv) informacion mbi raportin e aseteve të gjelbra, (v) tregues mbi përafërimin e bankës drejt objektivave ndërkombëtare të qëndrueshmërisë dhe (vi) veprime të tjera lehtësuese. Shpalosja zbatohet për vitin 2023, me informacionin e dhjetorit 2022, megjithëse ka disa heqje dorë (d.m.th., për raportin e aseteve të gjelbra)

²⁷ Banka Kombëtare e Hungarisë ishte autoriteti i parë që zbatoi këto shpalosje në vitin 2022

²⁸ EBA publikoi në maj 2022 një dokument diskutimi mbi rolin e rreziqeve mjedisore në kornizën prudenciale, duke përshkruar pikëpamjen e saj mbi mënyrën se si rreziqet e lidhura me klimën mund të përfshihen në kornizën aktuale për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rreziqet operationale, si për qasjet e standardizuara ashtu edhe për ato të avancuara, dhe gjithashtu duke marrë parasysh ndryshimet e ardhshme nga Bazel IV. Për më tepër, dokumenti diskuton gjithashtu mundësinë e prezantimit të Faktorëve Mbështetës të Gjelbër (GSF) dhe Faktorëve Penalizues të Kaftë (BPF) për të inkurajuar ose dekurajuar disa investime në sektorë të gjelbër ose të kaftë të ekonomisë

²⁹ Do të ketë fusha të tjera që ka të ngjarë të jenë kyçe për të mundësuar menaxhimin e shëndoshë të rreziqeve klimatike nga sektori bankar, të cilat nuk varen drejtpërdrejt nga puna e Bankës Qendrore, siç është, për shembull, zbatimi i një sistemi etiketimi për vlerësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave. Një sistem i tillë do të jetë kyç për të identifikuar, për shembull, kreditë

Në kontekstin e Deklaratës së Sofjes 2020 dhe shfaqjes së shpejtë të Taksonomisë së Gjelbër të BE-së si një standard i artë për klasifikimin e aktiviteteve ekonomike, Taksonomia Evropiane po bëhet me shpejtësi referenca kryesore në vendet e Ballkanit Perëndimor. Taksonomia e Gjelbër e BE-së u zhvillua nga KE-ja si pjesë e Planit të Veprimit të Qëndrueshëm të BE-së, i cili mbështet objektivat ambicioze të BE-së për klimë dhe energji për të reduktuar emetimet e gazeve serrë në zero karbon deri në vitin 2050 dhe përgjysmuar emetimet deri në vitin 2030. Ky ishte një proces me dy faza që konsiston në një propozim për një rregullore ("Rregullorja e Taksonomisë") në maj 2018, e ndjekur nga krijimi i Grupit Teknik të Ekspertëve (GTE) për financimin e qëndrueshëm në korrik 2018 për të bërë rekomandime në lidhje me aktivitetet "të pranueshme për taksonominë" dhe kriteret teknike të lidhura me to. Rregullorja u miratua përfundimisht në vitin 2020³⁰, dhe përshkruan gjashtë objektiva mjedisore dhe katër parime të aktivitetit të qëndrueshëm ekonomik. Këto objektiva dhe qëllime janë paraqitur në Kutia 3.

Kutia 3: Gjashtë objektivat mjedisore të BE-së dhe katër parimet për aktivitet të qëndrueshëm ekonomik³¹

Objektivat mjedisore të BE-së:

- 1) Zbutja e ndryshimeve klimatike.
- 2) Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.
- 3) Përdorimi dhe mbrojtja e qëndrueshme e burimeve ujore dhe detare.
- 4) Kalimi në ekonomi qarkore (me qark të mbyllur).
- 5) Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes.
- 6) Mbrojtja dhe restaurimi i biodiversitetit dhe ekosistemeve.

Parimet e BE-së për aktivitetin e qëndrueshëm ekonomik:

- a) Kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në një ose më shumë nga gjashtë objektivat mjedisore. Cilësimi i kontributit si i konsiderueshëm varet nga arritja e objektivit specifik mjedisor.
- b) Nuk dëmton në mënyrë të konsiderueshme asnjë nga objektivat mjedisore, që do të thotë se kontributi i konsiderueshëm në objektivin mjedisor nuk duhet të arrihet duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm objektivit tjetër mjedisor.
- c) Kryhet në përputhje me masat minimale të mbrojtjes sociale.
- d) I përmbahet kriterëve teknike.

Është me rëndësi të theksohet se sipas Rregullores së Taksonomisë së BE-së, Komisioni Evropian duhej të dilte me listën aktuale të aktiviteteve të qëndrueshme mjedisore duke përcaktuar kriteret teknike të shqyrtimit për çdo objektiv mjedisor nëpërmjet akteve të deleguara. Akti i parë i deleguar mbi aktivitetet e qëndrueshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe objektivat e zbutjes është publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe është i zbatueshëm që nga janari 2022³². Akti i dytë i deleguar për objektivat e mbetura është aprovuar në parim më 13 qershor 2023, duke ndryshuar gjithashtu aktin e parë të deleguar të mëparshëm për të shtuar aktivitetet ekonomike në listën e atyre që kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në objektivat e zbutjes së dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të qartësuar detyrimet e raportimit për aktivitetet shtesë dhe u miratua më 27 qershor 2023³³. Objektivi kryesor i kësaj taksonomie është të ndihmojë investitorët, kompanitë, emetuesit dhe promovuesit e projekteve të drejtojnë kalimin drejt ekonomisë me karbon të ulët, të qëndrueshme dhe me efikasitet të burimeve dhe të shërbejë si kornizë raportuese për rregulloren e re të BE-së për shpalsjet lidhur me klimën nga investitorët, korporatat dhe

hipotekare të gjelbra, pasi ato mund të përkufizohen si ato kredi hipotekare që u jepen klientëve për të blerë ndërtesa me efikasitet energjetike ose për të rinovuar ndërtesa me qëllim të përmirësimit të efikasitetit energjetik të atyre ndërtesave. Një sistem etiketimi, që pasqyron atë në BE, mund të zbatohet edhe për vlerësimin e efikasitetit energjetik të automjeteve.

³⁰ Rregullorja 2020/852 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020R0852&from=EN>

³¹ Taksonomia: Raporti përfundimtar i Grupit të Ekspertëve Teknik për Financat e Qëndrueshme, mars 2020

³² Rregullorja e deleguar e Komisionit 2021/2139 [-https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32021R2139](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32021R2139)

³³ https://finance.ec.europa.eu/publications/sustainable-finance-package-2023_en

bankat. Aktualisht zbatimi është i kufizuar vetëm në kompanitë me më shumë se 500 punonjës, korporata të listuara dhe banka. Ajo zbatohet gjithashtu për shtetet anëtare të BE-së pasi ato vendosin etiketa ose standarde në lidhje me produktet financiare ose obligacionet e korporatave të paraqitura si "të qëndrueshme mjedisore". Ajo përfaqëson një gjuhë të përbashkët për të gjitha palët e prekura nga rreziqet që lidhen me klimën dhe mjedisin.

2.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Ekzistojnë disa institucione globale që kërkojnë të nxjerrin parimet dhe praktikën më të mira globale, shkëmbimin e njohurive institucionale dhe koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar midis autoriteteve kombëtare në rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare. Përveç institucioneve të njohura evropiane (d.m.th. EBA) dhe globale (d.m.th. BCBS, FSB), janë krijuar forume të reja të specializuara për identifikimin e praktikave më të mira për matjen dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me klimën nëpër bankat qendrore dhe mbikëqyrësit bankarë.

Ndoshta më i rëndësishmi është Rrjeti për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS), i krijuar në vitin 2017 dhe që aktualisht përfshin 127 anëtarë dhe 20 vëzhgues³⁴ institucione mbikëqyrëse dhe banka qendrore, ku Banka Qendrore e Republikës së Kosovës tashmë ka aplikuar për anëtarësim.

Qëllimi i Rrjetit është të ndihmojë në forcimin e përgjigjes globale të kërkuar për të përmbushur qëllimet e Marrëveshjes së Parisit dhe për të rritur rolin e sistemit financiar për të menaxhuar rreziqet dhe për të mobilizuar kapitalin për investime të gjelbra dhe me karbon të ulët në kontekstin më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor. Për këtë qëllim, Rrjeti përcakton dhe promovon praktikën më të mira që do të zbatohen brenda dhe jashtë Anëtarësisë së NGFS dhe kryen ose porosit punë analitike për financat e gjelbra.³⁵

Një nismë tjetër është Platforma Ndërkombëtare për Financat e Qëndrueshme (IPSF), e krijuar në takimin e rregullt vjetor të FMN-së dhe Bankës Botërore në tetor 2019, nga përfaqësuesit e BE-së dhe vendeve të tjera.³⁶ Objektivi përfundimtar i IPSF-së është të rrisë mobilizimin e kapitalit privat drejt investimeve të qëndrueshme mjedisore. Prandaj, IPSF-ja ofron forum shumëpalësh dialogu midis politikëbërësve që janë përgjegjës për zhvillimin e masave rregullatore të financave të qëndrueshme për të ndihmuar investitorët të identifikojnë dhe shfrytëzojnë mundësitë e investimeve të qëndrueshme që vërtet kontribuojnë në objektivat klimatike dhe mjedisore. Nëpërmjet IPSF-së, anëtarët mund të shkëmbejnë dhe shpërndajnë informacion për promovimin e praktikave më të mira, për të krahasuar iniciativat e tyre të ndryshme dhe për të identifikuar barrierat dhe mundësitë e financimit të qëndrueshëm, duke respektuar kontekstet kombëtare dhe rajonale.³⁷

3. Ekspozimi dhe menaxhimi i rreziqeve klimatike në sektorin bankar në Republikën e Kosovës

3.1. Pasqyrë e sektorit financiar³⁸

Sektori financiar në Republikën e Kosovës është sektor financiar i dominuar nga bankat, pasi sektori bankar përbën 67.9% ose 7.5 miliardë Eur gjithsej aseteve financiare prej 9.89 miliardë

³⁴ Të dhënat deri më datë 13 qershor 2023. <https://www.ngfs.net/en/about-us/membership>

³⁵ Cituar nga: <https://www.ngfs.net/en/about-us/governance/origin-and-purpose>

³⁶ Autoritetet përkatëse të Argjentinës, Kanadasë, Kilit, Kinës, Indisë, Kenisë dhe Marokut.

³⁷ Platforma Ndërkombëtare për Financat e Qëndrueshme: https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/banking-and-finance/sustainable-finance/international-platform-sustainable-finance_en#documents

³⁸ Ky seksion është përgatitur në bazë të Raportit Vjetor të BQK-së për vitin 2023: [BQK RV 2023.pdf \(bqk-kos.org\)](https://www.bqk-kos.org/); dhe Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë i BQK-së, Nr.45: [BQK VTE TM42023.pdf \(bqk-kos.org\)](https://www.bqk-kos.org/);

euro në fund të vitit 2023. Pjesa tjetër e sistemit financiar përfaqëson pjesë më të vogël të sektorit për sa i përket asetëve financiare dhe përbëhet nga fondet pensionale (24.4%), kompanitë e sigurimit, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (4.1%). Sa i përket numrit të institucioneve, deri në fund të vitit 2023 në Republikën e Kosovës ishin 136 institucione aktive, të shpërndara sipas Tabela 1 më poshtë.


Tabela 1: Numri i institucioneve financiare dhe pjesa në Kosovë

Lloji i institucionit financiar	2023		
	Gjithsej	O/ë në pronësi të huaj	Pjesa (% e totalit të asetëve)
Bankat komerciale	12	9	67.9%
Siguruesit	12	6	2.7%
Fondet e pensioneve	2	1	24.4%
Ndërmjetësuesit e sigurimeve	16	7	Fusnota ³⁹
Institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jobankare	32	13	4.9%
Zyrat e këmbimit valutor	62	0	0.1%

Burimi: Informacioni mujor i BQK-së për sistemin financiar për dhjetor 2023

Sa i përket strukturës së bilancit, sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë, në raport me modelin tradicional të aktiviteteve, me shkallë të ulët të kompleksitetit dhe ndërlidhjes së aktiviteteve ndërmjet sektorëve brenda sistemit. Sa i përket asetëve, kreditë për klientët (si për individët ashtu edhe për korporatat jofinanciare) përfaqësojnë rreth 65.2%; paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në 12.1%, investimet në letra me vlerë (si në sektorin qeveritar ashtu edhe në atë privat) 11.9% dhe bilanci me bankat e tjera komerciale 8% (kryesisht depozitat ndërbankare), duke arritur në më shumë se 97 % të totalit të asetëve në sektorin bankar.

Figura 5: Bilanci i gjendjes së sektorit bankar - asetet




Burimi: Vlerësimi tremujor i ekonomisë i BQK-së, Nr.41

Sa i përket detyrimeve, depozitat përfaqësonin 81.3% të burimeve të financimit të sektorit bankar (kryesisht nga ekonomitë familjare), të ndjekura nga burimet vetanake (kapitali). Në këtë kuptim, është e rëndësishme të theksohet se disa banka të mëdha në vend mbështeten pjesërisht, ose mund të mbështeten në rast se kanë nevojë, në financimin nga kompanitë e tyre amë të huaja, për sa i përket depozitave, pretendimeve ose burimeve të tjera të financimit.

³⁹Të dhënat e përfshira në seksionin "siguruesit".

Figura 6: Stoku i totalit të depozitave



Burimi: Vlerësimi tremujor i ekonomisë i BQK-së, Nr.41

Përveç bilancit të mirë-balancuar, ku shumat e depozitave në masë të madhe e tejkalojnë volumin në kredi (duke siguruar kështu që aktiviteti kreditues për klientët financohet me fonde nga klientët), është e rëndësishme të theksohet se bankat në Republikën e Kosovës mbështeten në:

- Raportet e larta të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, me nivel prej 16.5% në fund të vitit 2023, duke treguar një nivel të lartë të shtesës së kapitalit krahasuar me kërkesat minimale të kapitalit për bankat.
- Raportin e aseteve likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra prej 34.7%.
- Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive bruto prej 2.0%, e plotësuar me raportin e provizioneve për humbjet e kredive ndaj KJP-ve prej 147.1%.

Në fund, kur shikohet performanca financiare e bankave në Republikën e Kosovës, mund të theksohen këto aspekte:

- Sektori bankar realizoi fitim vjetor në vlerë prej EUR 155.3 milionë në vitin 2023, që paraqet vlerën më të lartë të regjistruar që nga themelimi i sektorit bankar (me çmime konstante).
- Ekziston dallim i konsiderueshëm midis kostos së financimit, p.sh. mesatarisht 3.1% e paguar në depozita kundrejt 6.3% të ngarkuar ndaj korporatave jofinanciare, respektivisht ekonomive familjare.

3.2. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën (FinSAC)

3.2.1. Identifikimi i rreziqeve kryesore të lidhura me klimën

Bankat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve financiare të lidhura me klimën nëpërmjet dy kanaleve kryesore, rreziqeve fizike dhe rreziqeve të tranzicionit. Rreziqet fizike burojnë drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike, ndërsa rreziqet e tranzicionit lindin nga reagimi – nga politikbërësit, inovatorët ose konsumatorët – për të parandaluar dhe/ose luftuar ndryshimet klimatike.

Rreziqet fizike i referohen efekteve të rritjes së temperaturave dhe ngjarjeve ekstreme të motit, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Ato mund të ndahen në rreziqe akute dhe kronike: rreziqet akute janë ngjarje të papritura të shkurtra dhe të rënda që kanë ndikim të konsiderueshëm negativ, p.sh., reshjet e mëdha të shiut që shkaktojnë përmytje. Rreziqet kronike pasqyrojnë përkeqësimin e vazhdueshëm të kushteve ekologjike, p.sh. ngritja e nivelit të detit.

Rreziqet fizike, të cilat mund të dëmtojnë infrastrukturën materiale dhe investimet fikse dallojnë nga rajoni në rajon, duke prekur, për shembull, zonat bregdetare ndryshe nga rajonet e akullnajave. Rreziqet fizike të lidhura me klimën bien në kategori më tradicionale në menaxhimin e rrezikut financiar. Pasi të materializohen rreziqet fizike, ato mund të shkatërrojnë asetet ose në mënyrë të menjëhershme ose gradualisht, për shembull duke shkaktuar përsheptimin e normës së amortizimit të kapitalit nëpërmjet korrozionit. Nëse asetet e prekura janë lënë peng si kolateral për kredi, rreziku kreditor i origjinuesit të kredisë rritet. Shumë rreziqe fizike janë të ndërlidhura në aspektin hapësinor: nëse, për shembull, përmbytjet e rënda shkatërrojnë pjesë të konsiderueshme të kolateralit të pasurive të paluajtshme në zonë të caktuar, kredidhënësit në atë rajon mund të përballen me rrezik më të lartë përqendrimi. Nëse çmimi vendoset në përputhje me rrethanat, pasiguria në rritje për shkak të ndryshimeve klimatike mund të çojë gjithashtu në prime më të larta të rrezikut mbi normat e interesit, gjë që, nga ana tjetër, rrit rrezikun e tregut.

Rreziqet e tranzicionit janë të lidhura me përpjekjet për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike si pjesë e tranzicionit nga mënyrat aktuale të prodhimit në një ekonomi më miqësore ndaj klimës. Ulja e emetimeve të CO₂, në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit, kërkon politika klimatike të shënjestruara (p.sh. taksat e karbonit), ndryshime të ligjeve dhe rregulloreve, si dhe risi teknike dhe ndryshime në sjelljen e konsumatorëve. Megjithatë, nëse tranzicioni është i çrregullt, për shkak se politikat klimatike prezantohen shumë vonë dhe/ose në mënyrë të pakoordinuar nëpër vende dhe ndikimi i tyre nuk mund të parashikohet plotësisht nga investitorët, mund të shfaqen burime të reja të rreziqeve financiare. Tranzicioni i çrregullt mund të shkaktojë paqëndrueshmëri të çmimeve të aseteve (si negative për aktivitetet me karbon të lartë ashtu edhe pozitive për asetet me karbon të ulët) me implikime për paqëndrueshmëri financiare nëse përfshihen klasa të mëdha dhe të ndërlidhura të aseteve⁴⁰.

Ndryshimet rregullatore mund të ndryshojnë çmimet relative të mënyrave të prodhimit me karbon të ulët dhe gri. Politikat që internalizojnë eksternalitetet negative të klimës përfshijnë çmimet e karbonit dhe skemat e tregtimit të emetimeve. Mund të vendosen tarifa për emetimin e gazeve serrë (GS), por këto rrezikojnë të ulin të ardhurat nga aktiviteti bazë ekonomik, duke ulur kështu kapacitetin e kthimit të borxhit të emetuesit; aksionet dhe obligacionet e kompanive që emetojnë GS do të zbriten në përputhje me rrethanat.

Më tej, përhapja e teknologjive neutrale ndaj klimës mund të veprojë si pikë kthese për tregjet dhe të transformojë investimet e mëparshme të vlefshme në asete të bllokuara, vlera e të cilave nuk është më e sigurt, pasi ato nuk mund të përdoren për shkak të barrierave rregullative, sociale ose teknike. Inovacioni teknologjik mund t'i zvogëlojë kostot e burimeve të ripërtërishtme të energjisë dhe t'i bëjë këto të fundit më konkurruese kundrejt lëndëve djegëse fosile, të cilat janë burimi kryesor i emetimeve të GS. Nga ana tjetër, kompanitë e qymyrit ose të naftës që kanë rezerva të pa-ekstraktuara në bilancet e tyre përballen me rreziqe të konsiderueshme negative në lidhje me çmimet e këtyre aseteve në të ardhmen në rast se përparimet teknologjike i kthejnë rezervat në asete të bllokuara. Përhapja e përsheptuar e paneleve diellore me kosto të ulët ose e pajisjeve të mobilitetit elektronik ka potencial pengues duke bllokuar makinat tradicionale që emetojnë GS-të.

Së fundi, rritja e ndërgjegjësimit për ngrohjen globale mund të ndryshojë preferencat e konsumatorëve dhe kështu të zvogëlojë kërkesën për mallra me intensitet karboni, duke i kthyer me shpejtësi asetet me rendiment të lartë në asete të bllokuara. Zhvlerësimi i konsiderueshëm i aseteve me bazë karboni dhe të ardhurat më të ulëta për debitorët për shkak të zhvendosjeve të kërkesës do të thotë se bankat përballen me probabilitet më të lartë të

⁴⁰ Monasterolo, I., S. Battiston, AC Janetos dhe Z. Zheng. 2017. E cenueshme por e rëndësishme: dy dimensionet e shpalosjes financiare të lidhur me klimën. Në: *Ndryshimet klimatike* 145. 495-507

mospagesës (dështimit) të disa prej kredive të tyre. Në varësi të kohës së ndryshimeve të sjelljes nga qeveritë, kompanitë dhe konsumatorët, tranzicioni mund të rezultojë në “aterim të lehtë” ose “aterim të vështirë”. Kjo e fundit do të siguronte asetë në një kohë kur ka gjasa të materializohen gjithnjë e më shumë rreziqet fizike.

Ekzistojnë gjithashtu rreziqe të detyrimeve (proceseve gjyqësore) që mund të dalin nga individët ose bizneset që kërkojnë kompensim për humbjet që mund të kenë pësuar nga rreziqet fizike ose të tranzicionit nga ndryshimet klimatike të përshkruara më sipër ose sfidat ligjore të ndërmarra për të kërkuar shteg të veçantë veprimi. Ndërsa rreziqet e proceseve gjyqësore janë identifikuar më parë si kanal më vete, ato konsiderohen gjithnjë e më shumë si nënkategori e rreziqeve fizike dhe të tranzicionit.


Karakteristikat kryesore të rreziqeve të lidhura me klimën janë:

- a) Ato janë **sistematike** dhe do të prekin çdo konsumator dhe çdo korporatë në të gjithë sektorët dhe në të gjitha vendet gjeografike. Ndikimi i tyre ka të ngjarë të jetë i ndërlidhur, jolinear, i pakthyeshem dhe do të ketë pika kthyesë. Prandaj, ato do të ndodhin në shkallë shumë më të lartë sesa rreziqet e tjera që firmat janë mësuar t'i modelojnë dhe menaxhojnë.
- b) Ato janë **njëkohësisht të pasigurta dhe megjithatë plotësisht të parashikueshme**. Rreziqet janë të pashmangshme, por vendimet për reduktimin e emetimeve do të ndikojnë në kombinimin e rreziqeve fizike dhe atyre të tranzicionit që shfaqen.
- c) **Veprimi i hershëm** mund të ndihmojë në zbutjen e përmasave dhe ekuilibrit të rreziqeve të ardhshme. Kur rreziqet fizike të fillojnë të shfaqen në mënyrë sistematike, atëherë mund të jetë tepër vonë për të prapësuar shumë efekte nëpërmjet reduktimit të emetimeve.

3.2.2. Kanalet e transmetimit

Integrimi i shëndoshë i rreziqeve financiare të lidhura me klimën në kornizat e menaxhimit të rrezikut të bankave kërkon një kuptim të thellë dhe gjithëpërfshirës të kanaleve ekzistuese dhe potenciale të transmetimit midis ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të bankave. Kjo rrugë nuk është e drejtpërdrejtë dhe përfshinë efekte të rendit të dytë dhe të tretë nga aktivitetet ekonomike në banka, gjë që shton kompleksitetin gjatë modelimit të ndikimeve. Kanalet më të rëndësishme të transmetimit janë përmbledhur në Figura 7.

Figura 7: Kanalet kryesore të transmetimit të ndryshimeve klimatike



Burimi: Rrjeti për Gjelbërimin e Sistemit Financiar

3.2.3. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tranzicionit

Bankat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve financiare të lidhura me klimën nëpërmjet aktiviteteve dhe operacioneve të tyre të biznesit. Për shembull, këto rreziqe mund të ndikojnë në probabilitetin e dështimit të kredive, duke rezultuar në humbje financiare më të mëdha se sa pritet. Për më tepër, bizneset mund të kenë vështirësi nga ndërprerja e operimit për shkak të rreziqeve fizike që çojnë në dëmtim të pronës në hapësirat e tyre ose ndikojnë në ofrimin e shërbimeve të palëve të treta tek të cilat ata mbështeten.

Kredidhënia bankare vazhdon të jetë burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit të sektorit privat në Republikën e Kosovës, dhe ndërmjetësimi bankar vazhdon të ketë rritje në baza vjetore. Këto banka janë të ekspozuara ndaj rreziqeve klimatike. Në këtë drejtim, rreziqet klimatike mund ta dëmtojnë vlerën e aseteve financiare, të cilat në skenar ekstrem mund të ndikojnë në solvencën e ndërmjetësve financiarë që i mbajnë ato. Nëse rreziqet nga ndryshimet klimatike nuk vlerësohen mjaftueshëm, vendimet për kredidhënien dhe investimet mund të bazohen në informacione jo të plota, duke rezultuar në kthim të paragjykuar të pritshëm të investimit të rregulluar sipas rrezikut. Kjo është arsyeja pse bankave do t'u kërkohet në mënyrë progresive të vlerësojnë, matin dhe menaxhojnë në mënyrë adekuate rreziqet e tyre të lidhura me klimën, veçanërisht mënyrën se si integrohen rreziqet e lidhura me klimën në kornizën e menaxhimit të rrezikut kreditor të bankave.

Kuantifikimi i rreziqeve financiare të lidhura me klimën (si fizike ashtu edhe të tranzicionit) kërkon të dhëna të besueshme për ekspozimet e bankave ndaj rrezikut kreditor, kryesisht ndaj korporatave jofinanciare (përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) dhe ekonomitë familjare. Këto të dhëna aktualisht nuk janë plotësisht në dispozicion⁴¹. Megjithatë, vlerësimi fillestar i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve të tranzicionit që rrjedhin nga rreziqet klimatike mund të matet duke zbrëthyer portofolin e kredive të bankave të kompanive jofinanciare sipas sektorëve ekonomikë; duke identifikuar ekspozimin aktual ndaj sektorëve më

⁴¹ Përdoret një klasifikim alternativ sepse Kosova nuk mbështetet në një Taksonomi vetanake të Gjellbër që përcakton sektorët përkatës dhe kjo është përdorur gjerësisht nga autoritetet e tjera (BQE dhe OeNB ndër të tjera) dhe komuniteti akademik

të ndjeshëm ndaj rreziqeve të tranzicionit. Sektorët përkatës të lidhur me klimën klasifikohen duke përdorur klasifikim 4-shifror NACE (sistemi i klasifikimit standard të industrisë që përdoret në Bashkimin Evropian). Megjithatë ky klasifikim nuk është projektuar në mënyrë perfekte për të mbuluar të gjithë sektorët të lidhura me klimën dhe mund të mos jetë aq i detajuar sa duhet, ai përdoret gjerësisht nga autoritetet dhe tregjet e tjera për të matur ekspozimet bankare ndaj rreziqeve të tranzicionit.

Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike që lidhen me politikën klimatike bazohet në Battiston et al. (2017)⁴² ku ato quhen Sektorë Relevantë të Politikës Klimatike (SRPK) dhe përkufizohen si aktivitete ekonomike që mund të ndikohen pozitivisht ose negativisht (duke përfshirë shndërrimin në asete të bllokuara) në një tranzicion të çrregullt, d.m.th., ato janë relevante për vlerësimin e rrezikut të tranzicionit klimatik. Me përdorimin e klasifikimit të nivelit 4 të NACE-së dhe transformimin e ekspozimeve ndaj sektorëve të NACE-së në ekspozime ndaj SRPK-së, gjashtë sektorë përcaktohen si relevantë për politikën klimatike: (i) lëndët djegëse fosile, (ii) shërbimet komunale, (iii) me energji intensive, (iv) ndërtesat, (v) transporti dhe (vi) bujqësia. Klasifikimi i sektorëve është paraqitur në Tabela 2.

Tabela 2: Klasifikimi i sektorëve sipas NACE-së

CPRS	Roli në emetimin e gazrave serrë	Rreziku i tranzicionit	NACE (kodi 4-shifror)
Lëndët djegëse fosile	Prodhimi i energjisë primare të bazuar në lëndë djegëse fosile; në mënyrë indirekte përgjegjës për emetimet e GS-ve nga lëndët djegëse fosile	Të ardhurat kryesisht nga lëndët djegëse fosile (p.sh. nxjerrja, rafinimi); diversifikimi/përdorimi i burimeve të ndryshme nuk është i mundur	Nxjerrja e qymyrit, gazit dhe naftës (p.sh., 05.20), prodhimi në lidhje me rafinimin e qymyrit, gazit dhe naftës (p.sh., 19.10) energjisë elektrike dhe gazit (p.sh., 35.21), shitjet me pakicë të karburanteve për automobila (p.sh., 47.30)
Shërbimet komunale	Prodhimi i energjisë sekondare; përgjegjës për emetimet e GS-ve në lidhje me llojin e karburantit të përdorur	Të hyrat nga prodhimi, transmetimi ose shpërndarja e energjisë elektrike; diversifikimi i mundshëm (p.sh. diellore, të erës)	Prodhimi i energjisë elektrike (p.sh., 35.11)
Me energji intensive	Aktivitetet me përdorim intensiv të energjisë si input	Ndikuar nga ndryshimet e çmimeve të energjisë ose kufizimet në përdorimin e burimeve me intensitet të GS-ve	Minierat dhe gurëthyesit (p.sh., 07.10), sektorë të ndryshëm të prodhimit (p.sh., 11.01, 13.10, 23.51) bazuar në listën e BE-së të rrjedhjeve të karbonit
Ndërtesat	Ofrimi i shërbimeve të ndërtimit nga ndërtimi deri tek marrja me qira	Përdor intensivisht energji, por diversifikimi i mundshëm	Ndërtimet rezidenciale dhe komerciale (p.sh., 41.10), akomodimi (p.sh., 55.10), patundshmëritë (p.sh., 68.20)
Transporti	Ofrimi dhe mbështetja e shërbimeve të transportit	Përdor intensivisht karburante fosile, por pa varësi të konsiderueshme në emetimet e GS-ve; diversifikimi i mundshëm	Prodhimi i automjeteve, anijeve dhe trenave (p.sh., 29.10), ndërtimi i rrugëve (p.sh., 42.11), shitja e automjeteve (p.sh., 45.32), transporti (p.sh., 49.10)
Bujqësia	Bujqësia, pylltaria dhe shërbimet e ngjashme	Me intensitet të energjisë, por diversifikimi i mundshëm	Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (p.sh., 1.10)


Burimi: [Raporti i Stabilitetit Financiar OeNB 40 – Nëntor 2020](#)

⁴²Battiston, S., A. Mandel, I. Monasterolo, F. Schütze dhe G. Visentin. 2017. Një stres-test klimatik i sistemit financiar të BE-së. Në: Nature Climate Change 7. 283–88.

Shtatë banka në Republikën e Kosovës kanë marrë pjesë në pyetësorin “Rreziqet e lidhura me klimën në sektorin bankar”, të cilat përbëjnë rreth 86% të totalit të aseteve të sektorit bankar në Republikën e Kosovës. Qëllimi i anketës ishte të nxirrte pasqyrë ilustruese të gatishmërisë, aftësisë dhe kapacitetit të brendshëm të bankave për të përfshirë rreziqet e lidhura me klimën në strategjinë, qeverisjen dhe praktikën e tyre të menaxhimit të rrezikut. Shtatëdhjetë pyetjet në anketë kishin të bënin me informacionet cilësore mbi praktikën aktuale të bankave në një sërë fushash kritike.

Përqindja e sektorëve të CPRS-së dhe e sektorëve të tjerë në ekspozimin total të bankave në Republikën e Kosovës në vitet e fundit duke ndjekur këtë metodologji është paraqitur në Figura 8.

Figura 8: Pjesa e CPRS-së dhe e sektorëve të tjerë në ekspozimin e bankave të Republikës së Kosovës 2018-2022⁴³




Burimi: Llogaritjet e brendshme të bazuara në të dhënat e ofruara nga bankat në Republikën e Kosovës deri në muajin shtator të vitit 2023

Më pak se gjysma e ekspozimit total të bankave në Republikën e Kosovës i atribuohet Sektorëve Relevantë të Politikave Klimatike (CPRS). Pjesa e CPRS-së në ekspozimin e bankave në pesë vitet e fundit është ndërmjet 41.7% dhe 43.9%, dhe ndërmjet 56.1% dhe 58.3% ndaj sektorëve të tjerë, duke treguar nivel relativisht të qëndrueshëm gjatë pesë viteve. Megjithatë, është shenjë e mirë për sektorin bankar që pjesa e CPRS-së nuk është dominuese në krahasim me sektorët e tjerë që nuk janë relevantë për politikën klimatike. Kjo tregon se bankat nuk investojnë kryesisht në sektorë të ndjeshëm ndaj klimës që mund t'u shkaktojnë atyre rreziqe të mëdha tranzicioni. Megjithatë, në bazë të të dhënave të analizuar nuk është e mundur të përcaktohet madhësia e rreziqeve, vetëm të përcaktohet ekspozimi ndaj tyre.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj secilit prej gjashtë CPRS-ve relevante për rrezikun e tranzicionit është paraqitur në Figura 9. Ajo tregon se pesha në secilin sektor ka mbetur mjaft konstante gjatë periudhës kohore të vëzhguar. Analizat më të detajuara të debitorëve specifikë do të tregonin nëse ekspozimi lidhet me disa kreditorë me kredi të mëdha apo me shumë kompani më të vogla.

⁴³ Vlerësimi merr parasysh informacionet e ofruara drejtpërdrejt nga bankat në Kosovë. Për hir të rezultateve më të besueshme, janë marrë në konsideratë të dhënat nga 5 banka nga 8 bankat pjesëmarrëse në ushtrim (që përfaqësojnë 71.57% të shumës së mbetur aktive të ekspozimeve deri në muajin dhjetor të vitit 2022). 3 bankat që nuk morën pjesë në vlerësim ose dhanë informacione të zbërthyer sipas NACE-1 (është e rëndësishme të theksohet se ka klasifikime NACE-1 që përmbajnë shumë CPRS të ndryshme dhe i grumbullojnë të gjitha në vetëm një CPRS [p.sh., brenda mbizotëruesit në atë NACE-1 do të anonte vlerësimin]) ose sipas klasifikimeve të brendshme.

Figura 9: Zbërthimi i ekspozimit të bankave ndaj sektorëve të lidhur me politikën klimatike për periudhën 2018-2022



Burimi: Llogaritjet e brendshme të bazuara në të dhënat e ofruara nga bankat në Republikën e Kosovës deri në shtator 2023

Spektori i vetëm me ekspozimin më të madh të bankave në Republikën e Kosovës ndaj rrezikut të tranzicionit është sektori i “Ndërtesave”, që përfshinë ndërtimet rezidenciale dhe komerciale, aktivitetet e qirasë dhe patundshmëritë. Pjesa në ekspozimin total në periudhën 5-vjeçare të analizuar është ndërmjet 14.0% dhe 18.4%, duke shfaqur trend rritës ndërmjet viteve 2018 dhe 2020 dhe trend rënës më pas.

Ekspozimi i dytë më i madh që kanë bankat në Republikën e Kosovës në CPRS është ndaj atij “me energji intensive”. Ky përfshinë aktivitete që kërkojnë përdorim të konsiderueshëm të energjisë, të tilla si minierat dhe gurëthyesit, dhe sektorët e ndryshëm të prodhimit që janë përcaktuar të kenë përdorim intensiv të energjisë bazuar në listën e BE-së të rrjedhjeve të karbonit. Pjesa për këtë sektor është ndërmjet 7.6% dhe 9.6%.

Ekspozimi i tretë më i madh është ndaj sektorit të “Transportit”, që përfshin prodhimin e mjeteve të transportit, ndërtimin e rrugëve, shitjen e automjeteve dhe shërbimet e transportit. Ky sektor është në mënyrë të konsiderueshme i ekspozuar ndaj rreziqeve të tranzicionit, për shembull nëpërmjet prezantimit të rregulloreve të reja për të përmirësuar efikasitetin energjetik të automjeteve, çmimet më të larta të lëndëve djegëse fosile për shkak të taksave të karbonit, ose rregulloreve të tjera mjedisore që mund të rrisin kostot e prodhimit ose të mirëmbajtjes. Për më tepër, mund të ketë ulje të kërkesës për shërbime ose produkte të caktuara. Lëvizja drejt përdorimit më të madh të automjeteve elektrike dhe vendosja e taksave të karbonit do të paraqiste rreziqe të konsiderueshme për këto aktivitete. Sektori paraqet ndryshime të lehta gjatë periudhës së vëzhguar, duke lëvizur midis 7.3% dhe 8.0% përgjatë periudhës së vëzhguar.

Spektori i fundit që ka rreth ose mbi 5% është “Lëndët djegëse fosile”, që përfshinë kryesisht nxjerrjen e linjtit (më i rëndësishmi në Republikën e Kosovës), por edhe nxjerrjen, ekstraktimin, prodhimin, shpërndarjen dhe transportin përmes tubacionit të lëndëve djegëse fosile të tjera si nafta dhe gazi natyror.

Në fund, ndër sektorët e mbetur vlen të përmendet ekspozimi ndaj “Bujqësisë”, që konsiderohet shumë i ndjeshëm ndaj klimës, tregon trend rënës gjatë periudhës, nga pesha prej 4% në vitin 2018 dhe më pak se 2.9% në vitin 2022. Njëra ndër arsyet për ekspozimin kaq të ulët mund të jetë se punëtorët e bujqësisë financojnë prodhimin e tyre nga burime të tjera

(burimet e veta) dhe jo nga bankat. Bujqësia si sektor shoqërohet me rrezik fizik shumë më të lartë sesa rrezik tranzicioni.

3.2.4. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve fizike

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve fizike nuk duhet neglizhuar, pasi mund të rezultojë në humbje të konsiderueshme për sektorin bankar. Megjithatë, në mungesë të të dhënave të modeluara të rreziqeve në vend, vlerësimi do të zbatohet në fazat e para të zbatimit të strategjisë.

4. Udhërrëfytyesi strategjik lidhur me rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin në sektorin financiar

4.1. Parimet

Udhërrëfytyesi Strategjik i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për trajtimin e rreziqeve të lidhura me klimën është përcaktuar në bazë të parimeve të mëposhtme:

- **Strategjia ka një qëllim të kombinuar** të rritjes së të kuptuarit të rreziqeve klimatike nga BQK-ja, duke siguruar që: (i) bankat t'i matin, vlerësojnë, menaxhojnë dhe kontrollojnë siç duhet rreziqet klimatike dhe mjedisore dhe (ii) BQK-ja mund ta masë në mënyrë gjithëpërfshirëse ekspozimin e bankave ndaj rreziqeve të lidhura me klimën.
- **Strategjia ka parasysh rolin e BQK-së.** Aktivitetet e planifikuara në Strategji marrin parasysh kompetencat dhe më gjerësisht mandatin ligjor të BQK-së. Roli i BQK-së duhet të ndërlidhet me vlerësimin dhe menaxhimin e shëndoshë të rreziqeve klimatike nga sektori financiar. Mandati aktual i BQK-së nuk mbulon masa të tjera të rëndësishme ligjore, siç është vendosja në zbatim e taksonomisë së gjelbër, edhe kur këto elemente mund të luajnë rol të rëndësishëm për menaxhimin e këtyre rreziqeve brenda sektorit financiar.
- **BQK-ja nuk do të synojë drejtpërdrejt apo tërthorazi kanalizimin e rrjedhave financiare drejt investimeve të gjelbra, pasi do të jetë në kundërshtim me mandatin e saj prudencial.** Aktivitetet e BQK-së duhet të synojnë që bankat e mbikëqyrura të identifikojnë, matin, qeverisin, menaxhojnë, raportojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të sigurtë rreziqet klimatike ndaj të cilave janë ose mund të jenë të ekspozuara. BQK-ja nuk duhet t'i inkurajojë drejtpërdrejt apo tërthorazi bankat që të rrisin investimet e tyre të gjelbra. Masa të tilla mund të sjellin shtrembërime të tregut dhe potencialisht të jenë kundër mandatit prudencial të BQK-së.
- **Nevoja për qasje graduale dhe përsëritëse.** Prezantimi i rekomandimeve, udhëzimeve dhe rregulloreve duhet të jetë në përputhje me progresin e bërë nga vendi në tërësi në këtë fushë. Për më tepër, sigurimi që bankat të zbatojnë sistem të plotë për menaxhimin e rreziqeve klimatike ka të ngjarë të kërkojë periudhë shumëvjeçare, pasi bankat do të duhet të mbyllin hendeqet e konsiderueshme të të dhënave, ato metodologjike dhe të burimeve njerëzore.
- **Inkorporimi i regjimit rregullator do të jetë progresiv dhe fillimisht i bazuar në parime.** Së pari, BQK-ja do të zhvillojë rekomandime/udhëzime në formën e letrës këshilluese ku vendos standardet për menaxhimin e shëndoshë të këtyre rreziqeve. Qasja e bazuar në parime mund t'i mundësojë BQK-së që në mënyrë dinamike t'i përshtatë pritshmëritë e saj me progresin e bërë në mënyrë efektive nga sektori financiar. BQK-ja synon të zbatojë kërkesat e bazuara në rregulla (detyruese) kur të arrihet progres i mëtijshëm.
- **BQK-ja do të ndjekë aktivitetet e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare.** Edhe kur Republika e Kosovës nuk është pjesë e BE-së, ekzistojnë dy arsye që këshillojnë të ndiqen iniciativat rregullatore dhe mbikëqyrëse nga autoritetet evropiane. Së pari, sepse Republika e Kosovës është zotuar (kryesisht, përmes Deklaratës së Samitit të

Sofjes në vitin 2020) të përafrohet me objektivat e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane. Së dyti, korniza aktuale rregullative dhe mbikëqyrëse në Republikën e Kosovës është e bazuar në BE-në. Për më tepër, BQK-ja do të marrë parasysh rekomandimet nga organizatat ndërkombëtare, si Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (BCBS) ose Bordi i Stabilitetit Financiar (Financial Stability Board - FSB) dhe standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.

- **Angazhimi i vazhdueshëm me organizata ndërkombëtare dhe rajonale.** BQK-ja konsideron se ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve në aspektet e lidhura me klimën do të jetë kyçe për ndërtimin progresiv të kornizës rregullatore dhe mbikëqyrëse të rrezikut klimatik. Mbikëqyrësit prudencialë mund të përfitojnë nga shkëmbimi i pikëpamjeve dhe transferimi i njohurive ndërmjet mbikëqyrësve të ngjashëm dhe më të avancuar. Në baza ndërkombëtare, BQK-ja tashmë ka aplikuar për t'iu bashkuar Rrjetit për Gjellbërimin e Sektorit Financiar dhe do të merret parasysh Rrjeti i Qëndrueshëm Bankar. Në aspektin rajonal, BQK-ja parasheh angazhimin e saj në forume relevante, siç është Iniciativa e Vjenës.
- **Angazhimi me autoritetet e vendeve të tjera.** BQK-ja do të komunikojë dhe koordinohet me autoritetet tjera në vend. Kjo do të thotë se BQK-ja duhet gjithashtu të angazhohet në mënyrë aktive me Ministritë përkatëse që janë aktualisht të ngarkuar për çështjet klimatike dhe mjedisore.
- **Socializimi i Strategjisë.** BQK-ja do të organizojë konferenca të rregullta, fillimisht për të shpjeguar qasjen e saj ndaj rreziqeve që lidhen me klimën, por më pas për të diskutuar mbi zhvillimet e fundit në këtë fushë.
- **Nevoja për të integruar vlerësimin e rreziqeve klimatike në mekanizmat, mjetet dhe procedurat aktuale mbikëqyrëse.** Ekziston konsensus i qartë se rreziqet e lidhura me klimën nuk janë kategori individuale të rrezikut, por kryesisht nxitës rreziku për rreziqe të tjera (rreziqe kreditore, operacionale ose të tregut). Qëllimi i Strategjisë duhet të jetë së pari të sigurojë që bankat nën kompetencën e BQK-së të integrojnë rrezikun klimatik në kornizat e tyre të menaxhimit të rrezikut kreditor, të tregut, likuiditetit dhe atij operacional. Po ashtu, BQK-ja do të synojë të integrojë ekspozimin ndaj rreziqeve klimatike gjatë kryerjes së vlerësimit të modelit të biznesit, të qeverisjes korporatave dhe rreziqeve për pozicionin e kapitalit të bankës gjatë vlerësimit të Mbikëqyrjes Bankare të bazuar në rrezik.

4.2. Aktivitetet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

BQK-ja ka vendosur të ndajë aktivitetet e parapara në udhërrëfytyes në pesë kategori të ndryshme:

- **Veprimet rregullatore,** duke përfshirë nxjerrjen e rekomandimeve/udhëzimeve (letër këshilluese) ose rregulloreve për qeverisjen, vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve të lidhura me klimën, ose veprime të tjera rregullatore (ndryshime të qeverisjes korporative, shpalosja, rregulloret e ICAAP, etj.). Në faza të mëvonshme, BQK-ja mund ta konsiderojë, nëse korniza e tillë dakordohet në nivel evropian dhe/ose ndërkombëtar, të përfshijë rreziqet klimatike në kornizën rregullatore.
- **Veprimet mbikëqyrëse.** Pasi të jenë vendosur rekomandimet/udhëzimet (letër këshilluese), BQK-ja do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të vlerësuar pajtueshmërinë e bankave me kërkesat e reja, do të përditësojë mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe metodologjitë e tjera të vlerësimit që përdoren nga mbikëqyrësit në punën e tyre të përditshme.
- **Veprimet e stabilitetit financiar.** Vlerësimi i BQK-së për ndikimin e mundshëm të rreziqeve të lidhura me klimën në stabilitetin financiar të Republikës së Kosovës. Aktivitetet e BQK-së do të përfshijnë gjithashtu vlerësimin dhe kuptimin e plotë të

ekspozimit të bankave ndaj rreziqeve klimatike duke përdorur analizën e skenarëve dhe, kur është e aplikueshme, stres testet.

- **Angazhimi kombëtar dhe ndërkombëtar.** BQK-ja do të marrë pjesë në forume rajonale dhe ndërkombëtare për zgjerimin e ekspertizës dhe njohurive në këto fusha. BQK-ja angazhohet me autoritetet e tjera lokale përgjegjëse për ndryshimet klimatike (veçanërisht të rëndësishme për Taksonomitë e Gjelbra).
- **Kultura / njohuria.** Sipas kësaj rrjedhe pune, BQK-ja do të pritët të zhvillojë vlerësim të qëndrueshmërisë së aktiviteteve të zhvilluara nga vetë BQK-ja dhe aktiviteteve kërkimore. BQK-ja gjithashtu do të angazhohet rregullisht me universitetet.

Figura 10: Kategoritë e aktiviteteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

